




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure



R A P O R T
PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR PASURI UJORE
-Rekomandim i metodologjisë-

Prishtinë, 2023



Të dhëna për dokumentin:

Emri i dokumentit:	Raport për Shqyrtimin e Kërkesave për Pasuri i Ujore: Rekomandim i Metodologjisë
Hartuar nga:	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – Divizioni për Ujëra/Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave (MMPHI)
Datë:	10 gusht 2023

Autorë:	Shiqeri Dermaku, Udhëheqës i Divizionit të Ujërave/MMPHI 
	Fatmire Mani, Zyrtare Ligjore në Divizioni e Ujërave/MMPHI 
	Afrim Lajçi, Këshilltar për Rregullativë Ujore, Këshilli Ndërmënyësor për Ujëra 

SHKURTESAT:

AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
ARPL	Autoriteti i Rajonit të i Pellgjeve Lumore
BE	Bashkimi Evropian
DMMU	Departamenti i Mbrojtjes se Mjedisit dhe Ujërave
DPHNB	Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
DTM	Modeli Digjital i Terrenit ('Digital Terrain Model')
GPJ	Grupi Punues Joformal për shqyrtimin e kërkesave për prona ujore
KNMU	Këshilli Ndërmënyror për Ujëra
LKA	Ligji për Konflikt Administrativ
LPPA	Ligji i Procedurës se Përgjithshme Administrative
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
SIU	Sistemi Informativ Ujor ne kuadër te ARPL/MMPHI
SP	Sekretari i Përgjithshëm
UA	Udhëzim administrativ
VNM	Vlerësim i ndikimit ne mjedis
ZK	Zonë Kadastrale

PËRMBAJTJA:

1. HYRJE	7
1.1 Sfondi përgjithshëm.....	7
1.2 Metodologjia shqyrtuese lëndore	7
2. KRITERET/LEGJISLACIONI	8
2.1 Kriteret nga legjislacioni procedural.....	8
2.2 Kriteret nga legjislacioni material	8
2.2.1 Ligji Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore	8
2.2.2 Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës.....	9
2.2.3 UA MMPH Nr.05/2016 për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore.....	11
2.2.4 UA MMPH Nr.19/2015 për Mbrojtje nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave.....	12
2.2.5 Referenca nga legjislacioni/praktikat e Kroacisë	13
3. Lënda: PARKU I BIZNESIT NË MITROVICË.....	15
3.1 Sfondi/përshkrimi i kërkesës/metodologjia shqyrtuese.....	15
3.2 Shtrirja hapësinore e lokacionit lëndor	15
3.3 Analiza/Gjetjet	17
3.3.1 Gjendja kadastrale tematike	17
3.3.2 Studimi shkurtër hidrologjik	19
3.3.3 Modelimi hidraulik i zonës vërshuese me HEC-RAS.....	23
3.3.4 Përcaktimi i kufijve të pasurisë ujore.....	27
3.4 Konkluzionet lëndore	33
3.5 Rekomandimet lëndore	33
4. Lënda: GLAREVA SH.P.K.....	35
4.1 Sfondi/përshkrimi i kërkesës/metodologjia shqyrtuese.....	35
4.2 Shtrirja hapësinore e lokacionit lëndor	35
4.3 Analiza/Gjetjet	37
4.3.1 Gjendja kadastrale tematike	37

4.3.2 Studimi shkurtër hidrologjik	38
4.3.3 Modelimi hidraulik i zonës vërshuese me HEC-RAS.....	40
4.3.4 Përcaktimi i kufijve të pasurisë ujore	44
4.4 Konkluzionet Lëndore	54
4.4 Rekomandimet Lëndore	55
5. KONKLUZIONET E PËRGJITHSHME.....	56
6. REKOMANTIMET E PËRGJITHSHME.....	58
7. SHTOJCAT	59

LISTA E TABELAVE:

Tabela 1: Probabiliti i Prurjeve maksimale për periudha kthyesë në ST.H.Nedakoc **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 2: Ekstrakt i Qmax nga Projekti Kryesor Rreg.Lumit Sitnica **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 3: Kordinata e pikave poligonale..... **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 4: Kordinata e pikave poligonale..... **Error! Bookmark not defined.**

LISTA E FIGURAVE:

Figura 3-1: Shtrirja makro-hapësinore e Parkut të Biznesit në Mitrovicë	16
Figura 3-2: Shtrirja mikro-hapësinore e lokacionit të 'Parkut të Biznesit në Mitrovicë'	17
Figura 3-3: Skema tematike e kërkesës së Komunës së Mitrovicës.	18
Figura 3-4: Skema tematike e kërkesës së Komunës së Mitrovicës.	19
Figura 3-5: Skema hidrologjike e pellgjeve lëndore	20
Figura 3-6: Q1% sipas Met.Gumbel	21
Figura 3-7: Orto-Foto me DRON e Parkut të Biznesit Mitrovicë, më 18.01.23.....	23
Figura 3-8: DTM i Parkut të Biznesit Mitrovicë, datë 18.01.23	24
Figura 3-9: Hidrogrami i skenarit vërshues.....	24
Figura 3-10: Thellësitë e zonës vërshuese	25
Figura 3-11: Modeli i shpejtësive në zonën vërshuese.....	26
Figura 3-12: Modeli i lartësive mbidetare në zonën vërshuese	26
Figura 3-13: Foto e vërshimeve të zonës Parku i Biznesit, datë 13.01.2021	27

Figura 3-14: Harta e zonës vërshuese ne zonën e Parkut Biznesit ne Mitrovicë.....	28
Figura 3-15: Sipërfaqja vërshuese për Q1% dhe brezi bregujor me gjerësi 10 m.	29
Figura 3-16: Brezi bregujor i llogaritur ne sfond te parcelave kadastrale.	30
Figura 3-17:Brezi bregujor llogaritar mbi sfondin e parcelave kadastrale.....	31
Figura 4-1: Shtrirja makro-hapësinore e segmentit te lumit Gracanka	36
Figura 4-2: Shtrirja mikro-hapësinore e lokacionit te ‘Parkut te Biznesit ne Mitrovice’	37
Figura 4-3: Skema pasurisë publike ujore kadastrale në raport me parcelën në pronësi të “Gllarea” sh.p.k.	38
Figura 4-4: Skema hidrologjike e pellgjeve lëndore.....	39
Figura 4-5: Hidrogrami lumit Graçnka	40
Figura 4-6: Plani i Situacionit ‘Gllareva’ Sh.p.k	41
Figura 4-7: DTM i ‘Gllareva’Sh.p.k	42
Figura 4-8: Hidrogrami i skenarit vërshues.....	42
Figura 4-9:Thellësitë e zonës vërshuese	43
Figura 4-10: Modeli i shpejtësive dhe niveleve ne zonën vërshuese	44
Figura 4-11: Harta e zonës vërshuese tematike	45
Figura 4-12:Sipërfaqja vërshuese për Q1% dhe brezi bregujor me gjerësi 5 m.	46
Figura 4-13: Brezi bregujor i llogaritur ne kontekst te parcelave	47
Figura 4-14: Akset e Ujrrjedhes faktike dhe kadastrale ne begrand parcelave	48
Figura 4-15: Brezi bregujor llogaritar ne begrand te parcelave kadastrale.	50
Figura 4-16: Pasuria ujore publike me status ndryshuar	51
Figura 4-17: Parcela per ndryshim të statusit.....	52

1. HYRJE

1.1 Sfondi përgjithshëm

Ne kontekst të hulumtimit të zgjidhjes së problematikave administrative e teknike të kërkesave për 'pasuri ujore', si rezultat i diskutimeve të takimit 'Retreat për Ujëra' (Kabineti MMPHI-DU/DMMU-ARPL) të datës 11.11.2022, pas punëve përgatitore kontekstuale DU/DMMU dhe KNU, me 22.11.2022 rezultoi vetëformimi i 'Grupit Punues Joformal (tutje-GPJ) për shqyrtimin e kërkesave për pasuri ujore' në përbërjen vijuese:

1. Shiqeri Dermaku-Udhëheqës i DU/DMMU
2. Fatmire Mani-Zyrtare ligjore DU/DMMU
3. Afrim Lajçi- Këshilltar për Rregullativë të Ujërave në KNU

GPJ, bazuar në praktikat e pilot-projekteve, nga 10 kërkesat (aplikacionet) e palëve për shfrytëzim/rregullim të pronave ujore drejtuar ARPL, përzgjedhi 3 kërkesa të tematikave të ndryshme, përfaqësuesëve të të cilave iu adresua formalisht për plotësim të aplikacioneve me dokumente teknike shtesë. Nga tre rastet (kërkesat) e përzgjedhura, sipas kriterit tematik/statistikor, kërkesës së GPJ iu përgjigjen vetëm 2 prej tyre, aplikacionet e të cilëve janë subjekt i këtij raporti.

1. Kërkesa e Kryetarit të Komunës së Mitrovicës për rregullim/shfrytëzim të pronave të "Parku i Biznesit në Mitrovicë", zona kadastrale Mitrovicë;
2. Kërkesa e "Gllareva" SHPK për kthim të lumit Graçanica në gjendje pronësore kadastrale në zonën kadastrale Fushë Kosovë .

1.2 Metodologjia shqyrtuese lëndore

Procesi i shqyrtimit të kërkesave për shfrytëzim/rregullim të pasurive ujore nga GPJ përfshin fazën e planifikimit, zhvillimit aktivitetëve shqyrtuese të dosjeve administrative e deri të hartimi i raportit të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Procesi në fjalë, përbëhet nga hapat vijues:

- identifikimi i kërkesave për shqyrtim vlerësim,
- identifikimi fushave tematike,
- sigurimi i dosjeve administrative mbështetëse nga ARPL,
- realizimi i 'shqyrtimit desktop' (shqyrtim i dosjeve në tavolinë) i dosjeve në fjalë,
- verifikimi i të dhënave të dosjeve kundrejt gjendjes faktike përmes inspektimit në terren,
- studimi i shkurtër hidrologjik tematik,
- përcaktim i zonës vërshuese përmes modelimit hidraulik me HEC-RAS si dhe përcaktimi i kufijve faktik të pasurisë ujore.

2. KRITERET/LEGJISLACIONI

Për faktin se sipas standardeve vlerësuese/shqyrtuese, te theksuara ne seksionin paraprak të këtij raporti 'metodologjia shqyrtuese lëndore' paraqet vlerësimin/shqyrtimin/analizën e përputhshmërisë ne relacionin 'kërkesë - kriteret' për të rezultuar me GJETJET, në vijim janë përshkruar kriteret sipas fushave vijuese:

2.1 Kriteret nga legjislacioni procedural

Për faktin se shqyrtimi i kërkesave për shfrytëzimin e pronave ujore më tepër i nënshtrohet kontekstit te legjislacionit material, shqyrtuesit e kërkesave duhet shfrytëzojnë si material referent raportin e publikuar nga MMPHI - *RAPORTI I GRUPIT PUNUES PER VLERËSIMIN E LËSHIMIT TE AKTEVE ADMINISTRATIVE TË MMPHI 2019-2021*

2.2 Kriteret nga legjislacioni material

Nga konsultimi legjislacionit vendor dhe standardet përkatëse, kane rezultuar kualifikimet vijuese legjislative materiale:

2.2.1 Ligji Nr.03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore

Dispozitat relevante të këtij ligji lidhur me çështjen që tarjtohet me këtë raport janë si vijon:

Neni 1: Fushëveprimi i Ligjit

5. Dispozitat e këtij ligji **nuk** aplikohen në të drejtat sendore publike ose vlerat pasurore të përbashkëta të **cilat rregullohen me ligje të veçanta**, përveç nëse **në mënyrë specifike parashihet ndryshe** me këtë ligj.

Koment:

Ne mungesë të rregullimit të çështjeve pronësore me Ligjin për Ujëra, ky ligj aplikohet te çështja e pronave publike. Çështja e servitutit në mënyrë specifike rregullohet me këtë ligj në nenin 253/3.

Neni 8: Sendi

Sendet konsiderohen sendet e luajtshme, **paluajtshmëritë** dhe të drejtat jo-trupore.

Neni 10: Paluejtshmëria

1. **Paluajtshmëria** është një pjesë e **caktuar e sipërfaqes tokësore**, e cila është e kufizuar ose mund të kufizohet. Paluajtshmëria përfshinë pasuritë natyrore nëntokësore, bimët me rrënjë nëntokësore dhe objektet tjera të lidhura me bazament tokësor.

2. Një paluajtshmëri përfshinë edhe:

- 2.1. një ndërtesë, e cila është në pronësi të një personi tjetër për dallim nga pronari i paluajtshmërisë, mbi të cilën është ndërtuar ndërtesa;
- 2.2. një njësi e ndërtuar që rregullohet sipas neneve 57-62;
- 2.3. e drejta e ndërtimit sipas neneve 271-281;
- 2.4. e **drejta e qirasë** sendore sipas dispozitave përkatëse mbi qiranë.

Neni 18: Pronësia

1. **Pronësia është e drejta e tërësishme në një send.** Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti.

Koment:

Pronari është Republika e Kosovës përfaqësuar nga QRK, kurse poseduesi i autorizuar është MMPHI.

Neni 253: Krijimi i servitutit sendor

1. **Servituti** sendor krijohet në bazë të një punë juridike, një vendimi të organit shtetëror ose një ligji.
2. Për krijimin e një servituti sendor sipas punës juridike është e nevojshme një kontratë dhe regjistrimi në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë. Me kontratë palët duhet të merren vesh, për krijimin dhe përmbajtjen e servitutit.
3. Dispozitat në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni do të zbatohen **në të gjitha rastet përveç** nëse me vendim administrativ ose me ligj të veçantë parashihet ndryshe.

Koment:

Pra, Neni 253.3 në mënyrë eksplicite përcakton se në të gjitha rastet (edhe në pronat publike) pra sqaron se ndalesat nga Neni 1.5 i Ligjit nuk zbatohen në rastin konkret.

Neni 265: Barra sendore

1. Një paluajtshmëri mund të ngarkohet në atë mënyrë, që një përfituesi nga ngarkimi **ti paguhen në mënyrë të përsëritshme detyrime të caktuara nga paluajtshmëria.**
2. Barra sendore mund të caktohet si në favor të një personi të caktuar (barra sendore personale) ose edhe në favor të pronarit përkatës të një paluajtshmërie tjetër (barra sendore).

Neni 272: Zbatimi i të drejtës sendore në paluajtshmëri në rastin e të drejtës së ndërtimit

Në të drejtën e ndërtimit zbatohen përshtatshmërisht dispozitat për paluajtshmëritë, posaçërisht ato për hipotekën.

Neni 273: Krijimi i të drejtës së ndërtimit

1. Për krijimin e të drejtës së ndërtimit është e nevojshme një **kontratë** në mes pronarit të paluajtshmërisë dhe përfituesit me të cilën palët merren vesh për krijimin e të drejtës së ndërtimit si dhe **regjistrimi i të drejtës** në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë.

Neni 275: Kompensimi i shfrytëzimit (për çështje të ndërtimit)

1. Në qoftë se për kompensim për shfrytëzimin e paluajtshmërisë është kushtëzuar një kompensim në pagesa të përsëritshme, atëherë për kompensimin e shfrytëzimit zbatohen përshtatshmërisht dispozitat për **barrën sendore.**

2.2.2 Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës

Ligji për Ujëra nuk e ka rregulluar në mënyrë të plotë dhe të detajuar pasurinë ujore. Përkundrazi, në këtë ligj, pasuria ujore është trajtuar në mënyrë të mangët dhe madje me disa paqartësi të dukshme. Kështu, përderisa në nenin 1 të këtij ligji është përcaktuar se “Resurset ujore janë pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës që ruhen e mbrohen me ligj” dhe njëkohësisht në nenin 4 resurset ujore janë përkufizuar si “të gjithë ujërat e brendshëm sipërfaqësor dhe nëntokësor, akuiferat dhe reshjet atmosferike,

përfshirë edhe tokat ujore”, në anën tjetër, në nenin 8 parashihet mundësia që resurset ujore të jenë edhe në pronësi private dhe në këto raste Ministri mund t’i shpallë pasuri publike ujore artificiale.

Neni 8: Pasuritë ujore artificiale

Sa i përket pasurisë ujore, në nenin 8, Ligji për Ujëra është rregulluar vetëm pasuria ujore artificiale si: (i) resurset ujore të cilat janë krijuar si rezultat i zhvendosjes apo rregullimit të rrjedhave natyrore ujore; dhe (ii) marrjen e ujërave, eksploatimin e inerteve apo veprimtarive të ngjashme.

Në këtë nen, përcaktohet se “në rastet, kur resurset ujore janë në pronësi private (!), Ministri me vendim mund t’i shpallë pasuri ujore publike artificiale, kurse procedura e regjistrimit të hapësirës, si pasuri publike ujore, bëhet në pajtim me ligjin. Gjithashtu, me këtë nen është përcaktuar se Ministri me akt nënligjor, do të rregullojë mënyrën e shpalljes dhe humbjes së statusit, nga paragrafi 4. I këtij neni.

Neni 9: Formimi i statusit të pasurive ujore natyrore

Edhe në nenin 9 të Ligjit për Ujëra nënkuptohet mundësia që resurset ujore mund të mos jenë pronë e Republikës së Kosovës meqenëse në këtë nen thuhet që “pronarit ose poseduesit të tokës dhe të resurseve ujore, mund t’i kufizohet shfrytëzimi i tyre, në pajtim me ligjin” për qëllime të mbrojtjes së ujërave, shfrytëzimit të përgjithshëm të ujit, pasurive tjera ujore të cilat kryhen për nevoja të interesit publik.

Neni 10: Kufizimet për përdorim publik

Në nenin 10 të Ligjit, paragrafi 1, janë përcaktuar kufizimet e përdorimit të ujërave dhe pasurisë ujore. Në këtë nen është përcaktuar se:

“Kalimi në hapësirat fizike dhe ujëra, mund të lejohet vetëm për:

- qëllimet e ndërtimit dhe instalimit të pajisjeve të infrastrukturës publike;
- ndërtimit të pajisjeve për pasuritë artificiale, të parapara me këtë ligj dhe aktet nënligjore, të dalura nga ky ligj;
- masave të zbatuara për përmirësimin e karakteristikave hidromorfologjike dhe biologjike, të ujërave sipërfaqësore;
- masave të zbatuara për mbrojtje të natyrës;
- ndërtimit të pajisjeve të nevojshme;
- ndërtimit të objekteve për përdorim të ujërave;
- mbrojtjes nga përmytjet;
- shfrytëzimit të banjove natyrore; dhe
- vendosjes së pajisjeve të caktuara, për siguri publike dhe shpëtim.”

Në këtë paragraf nuk është përkufizuar qartë çka nënkuptojnë ‘hapësirat fizike’ por mund të nënkuptohet se ato përfshijnë pasurinë ujore, respektivisht tokën ujore. në paragrafin 5 të këtij neni thuhet shprehimisht: “Pronari ose poseduesi i ujërave dhe resurseve ujore, nuk ka të drejtë në kompensim, për kufizimet nga paragrafi 1. i këtij neni, përveç dëmit të zakonshëm.” Pra ky formulim është në kundërshtim me nenin 1 të Ligjit ku thuhet se resurset ujore janë pasuri me interes të përgjithshëm dhe pronë e Republikës së Kosovës që ruhen e mbrohen me ligj.

Si konkluzion, nga neni 10 i Ligjit për Ujëra, është përcaktuar se në tokën ujore dhe ujëra mund të lejohet punët, ndërtimet dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin publik të ujërave si: ndërtimi i infrastrukturës publike, mbrojtje nga përmytjet, përmirësimin e karakteristikave hidromorfologjike të ujërave, si dhe ndërtimin e objekteve dhe pajisjeve për shfrytëzim të ujërave.

2.2.3 UA MMPH Nr.05/2016 për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore

Neni 1: Qëllimi

Ky udhëzim administrativ ka për qëllim rregullimin e statusit të pasurisë ujore përfshirë mënyrën e shfrytëzimit të sajë si dhe kushtet e shpalljes së një pasurie ujore si pasuri ujore publike si dhe kushtet e ndërprerjes së statusit të një pasurie ujore publike.

Neni 3.1.6: Shtrati i ujerave të mëdha

Shtrati i ujërave të mëdha-nënkupton shtratin e ujerrjedhes të dimensionuar për ujëra me periudhë kthyesë 100-vjeçare.

Neni 4: Pasuria Ujore

2. Pasuria ujore e ujërave rrjedhëse është shtrati i ujërrjedhës dhe brezit bregujor.

Neni 5: Brezi bregujor

1. Brezi bregujor është brezi tokësor i ngjitur me shtratin e ujerrjedhës që shërben për mirëmbajtjen e objekteve rregulluese dhe mbrojtëse si dhe për mirëmbajtjen e brezit të inundacionit dhe aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me menaxhimin e ujerave;
2. Për ujerrjedhat e rendit të parë, të dhënë në Shtojcën I të këtij Udhëzimi, gjerësia e brezit bregujor është;
 - 2.1 Dhjetë (10) metra nga pika e skajshme e anës së jashtme të shtratit të ujërave të mëdha në zonat urbane dhe ku shtrati i ujërrjedhës është i rregulluar;
 - 2.2 tridhjetë (30) metra nga vija nga vija e plotave në zonat ku shtrati i ujërrjedhave nuk është i rregulluar;
3. Për të gjitha ujërrjedhat tjera, gjerësia e brezit bregujor është pesë(5) metra nga shtrati i ujërrjedhës.

Neni 8: Përcaktimi i kufijve të pasurisë ujore

1. Pasuria ujore është një sipërfaqe e veçantë e cila përcaktohet me kufijtë e saj;
2. Kufijtë e pasurisë ujore i përcakton Ministri me Vendim në bazë të rekomandimit të Autoritetit të Pellgjeve Lumore.

Koment:

Pra problematikë kryesore në çështjet e pronave ujore është përcaktimi i kufijve të pronave ujore, të cilit i paraprinë **përcaktimi i kufirit** përmes hartës/planit nga modeli hidraulik për T=100 vj.

Neni 12: Ndërprerja e statusit të pasurisë ujore publike

1. Një tokë e humb statusin e pasurisë ujore publike nëse:
 - 1.1. me vendim të Ministrit konstatohet se ajo tokë nuk është me e nevojshme për destinimet e përcaktuara sipas nenit 9 të këtij udhëzimi administrativ.;
 - 1.2 me vendim të Qeverisë së Kosovës përcaktohet që ajo pasuri ujore publike të shfrytëzohet për interesa tjera të përgjithshme;
3. Statusi i pasurisë ujore publike ndërpritet në ditën kur regjistrohet në librat kadastral ndryshimi i statusit të asaj pasurie në pajtim me vendimin e paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 13: Menaxhimi i pasurisë ujore publike

1. Menaxhimi i pasurisë ujore publike nënkupton shfrytëzimin, mirëmbajtjen, ruajtjen e kësaj pasurie në mënyrë që ajo të jete në gjendje të shërbejë destinimit të caktuar.

2. Përgjegjësia për menaxhimin e pasurisë ujore publike të përfshira në zonë urbane është e **komonave** ndërkah në zonën e pellgut lumore përgjegjës është **Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore**.

Neni 14: Ndërtimet e lejuara në pasurinë ujore publike

Me nenin 14 është përcaktuar se në pasurinë publike ujore nuk lejohen ndërtime tjera përpos objekteve:

- 1) të infrastrukturës publike (rrugët, hekurudhat, urat etj.);
- 2) për rregullimin dhe mbrojtjen e ujërave;
- 3) për përmirësimin e karakteristikave hidromorfologjike dhe biologjike të ujërave sipërfaqësor;
- 4) që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës;
- 5) për shfrytëzimin e ujërave (veprat ujëmarrëse dhe veprat e akumulimit);
- 6) për mbrojtjen e ujërave nga ndotja;
- 7) për nevojat e organeve shtetërore, mbrojtjen dhe shpëtimin e njerëzve, kafshëve dhe pronës nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera, dhe për kryerjen e detyrave të policisë;

2.2.4 UA MMPH Nr.19/2015 për Mbrojtje nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave

Neni 5: Menaxhimi i rrezikut nga vërshimet

1. Menaxhimi i rrezikut nga vërshimet përfshinë:
 - 1.1. vlerësimin paraprak të rrezikut nga vërshimet;
 - 1.2. përgatitjen e hartave të rrezikut nga vërshimet dhe të rrezikshmërisë së vërshimeve;
 - 1.3. hartimin e planeve për menaxhimin e rrezikut nga vërshimet për secilin prej pellgjeve lumore në Kosovë;
 - 1.4. hartimin e planeve operative të mbrojtjes nga vërshimet;
 - 1.5. hartimin e masave për mbrojtje të rregullt dhe emergjente nga vërshimet

Neni 6: Vlerësimi paraprak i rrezikut nga vërshimet

2. Vlerësimi nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet duke u bazuar në informacionet e disponueshme, [studimet ekzistuese](#) duke përfshirë ato [për ndikimin e mundshëm të ndryshimeve klimatike](#) në shkaktimin e vërshimeve.

Koment:

Projekti financuar nga USAID "Draft Micro-Location Flood Risk Assessment Study for The New Kosovo Power Plant", ku janë studiuar vërshimet në një segment të lumit 'Sitnica' përfshirë ndryshimet klimatike. Hartuesi: EKONERG for AECOM

Neni 7: Përgatitja e hartave të rrezikshmërisë së Vërshimeve dhe hartave të rrezikut nga Vërshimet

1. Për secilin pellg lumor në Kosovë duhet të përgatiten hartat e rrezikshmërisë së vërshimeve dhe hartat e rrezikut nga vërshimet në përpjesë të përshtatshme për zonat e identifikuara në nenin 7 paragrafin 4.
2. **Hartat e rrezikshmërisë** së vërshimeve duhet të përfshijnë zonat gjeografike të cilat mund të vërshohen bazuar në skenarët vijues:
 - 2.1. Vërshimet me probabilitet të ulët, ose skenarët e ngjarjeve ekstreme;
 - 2.2. vërshimet me probabilitet mesatar (periudha e probabilitetit ≥ 100 vj.
 - 2.3. vërshimet e probabilitetit të lartë nëse ka të tilla.
3. Për secilin prej skenarëve nga paragrafi 2 i këtij neni duhet të paraqiten elementet si vijon:
 - 3.1 Hapësira e vërshimit;
 - 3.2 Thellësia e ujit ose niveli i ujit, cilado që është me e përshtatshme;

3.3 Shpejtësia e vërshimit ose prurja relevante e ujit, sipas rastit

Koment:

Pra kufirit të pronave ujore, i paraprin përcaktimi i hapësirës së vërshimit, thellësisë së ujit e niveleve, shpejtësia e vërshimit dhe prurja relevante. Pas përcaktimi të hapësirës vërshuese (shtratit të madh 100 vj. aplikohet brezi bregudor, e tani të dyja së bashku përbejnë sipërfaqen e pronës ujore.

4. **Hartat e rrezikut** nga vërshimet duhet të paraqesin pasojat negative që mund të shkaktohen nga vërshimet sipas skenarëve të paraqitur në paragrafin 2 të këtij neni dhe të tregojnë si në vijim:

...

...

2.2.5 Referenca nga legjislacioni/praktikat e Kroacisë

Ligji i Ujërave të Kroacisë:

Neni 10:

Në pasurinë publike ujore, personat tjerë nuk mund të fitojnë të drejtën e pronësisë ose të drejtën tjetër sendore, përveç të drejtës së servitutit dhe të drejtës së ndërtimit në pajtim me këtë ligj.

Neni 12:

Personi i cili pa autorizim shfrytëzon pasurinë ujore publike nuk mund të realizojë të drejtën poseduese.

Koment:

Sipas Nenit 12/10 të Ligjit për Ujëra të Kroacisë, personat e tjerë **nuk mund të fitojnë të drejtën e pronësisë** ose të drejtën tjetër sendore, përveç të drejtës së servitutit dhe të drejtës së ndërtimit sipas atij ligji.

Sipas Nenit 12/8 të Ligjit për Ujëra të Kroacisë, pasuria ujore publike është **ne pronësi të** Republikës së Kroacisë.

Neni 13.1:

Pasuritë kadastrale nga neni 9 i këtij ligji pushojnë ta kenë statusin e pasurive ujore publike kur përgjithmonë (Trajno-gjate) pushojnë së ekzistuari veçoritë natyrore që e përcaktojnë prone ujore.

Neni 18/1:

Personave juridik dhe fizik, në një pjesë të pasurive ujore publike mund t'u jepet e drejta e qirasë, servitutit dhe ndërtimit për përmbushjen e nevojave të tyre ekonomike e personale, vetëm kjo e drejtë nuk mund të ndikojë në realizimin e qëllimeve të përcaktuara në Nenin 10 të këtij Ligji (1. Ndërtimin e objekteve mbrojtëse, 2. Mirembajtjen e shtratit dhe brigjeve dhe 3. Mbrojtjen nga vërshimet.)

18/3:

Vendimin¹⁾ për dhënien e të drejtave në paragrafin 1. të këtij neni e lëshojnë 'Hrvatske Vode' (që është autoritetet përgjegjës (ndërmarrje publike me status të posaqëm për menaxhimin e ujërave në Kroaci). Kopja e vendimit i dërgohet Ministrisë.

18/4 4:

Kontratën²⁾ mi qiranë, servitutit dhe të drejtën e ndërtimit në pasurinë ujore publike e lidhi 'Hrvatske Vode' në emër të Republikës së Kroacisë. Kopja e kontratës i dërgohet Ministrisë

Tjera:

Shënime:

¹⁾ *Ne harmoni me praktikën ligjore të kësaj dispozite, në rastin e Kosovës vendimin e merr Sekretari i Përgjithshëm (SP) me propozim të ARPL (pasi ARPL ende nuk është person juridik).*

²⁾ Ne rastin e Kosovës, kontratën e lidhë MMPHI në emër të Republikës së Kosovës, respektivisht SP me Palën e tretë.

Komente:

- Kufiri i tokës ujore është poligon , i cili përcaktohet me koordinata të sistemit kombëtar të koordinatave me saktësi të shkallës së paku 1:5000.

- Rregullat profesionale në mënyrë të drejtpërdrejt me legjislacion ose në mënyrë subsidiare janë pjesë përbërëse e legjislacionit pozitiv juridik.

- Zyrtari shtetëror punët duhet t'i kryejë në përputhje me ligjin, rregullat tjera dhe rregullat profesionale.

3. Lënda: PARKU I BIZNESIT NË MITROVICË

3.1 Sfondi/përshkrimi i kërkesës/metodologjia shqyrtuese

Kryetari i komunës së Mitrovicës, z. Bedri Hamza, i është drejtuar Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Ministrit të MMPHI me kërkesë (Nr. prot. 2649, datë 17.11.2022) për shqyrtimin e çështjes së pronës ujore të lumit Sitnica në seksionin ku është ndërtuar “Parku i Biznesit” (në tekstin e më tutjeshëm: Parku).

“Parku i Biznesit” në Mitrovicë është themeluar me vendim të Kuvendit Komunal të Mitrovicës në vitin 2002, dhe në vitin 2006, me vendim të Kuvendit Komunal, është dhënë në shfrytëzim toka për Park.

Në vitin 2012 (më 8/12/2012), me vendim të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), “Parku i Biznesit” është shpallur zonë ekonomike në pajtim me Ligjin nr. Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike. Shpallja e Parkut zonë ekonomike është bërë edhe me Vendim të Kryeministrit, më datë 17 tetor 2012.

Parku ka një sipërfaqe prej 3.5 hektarësh dhe në të janë të vendosura 22 biznese të cilat i kanë të punësuar rreth 300 punëtorë. Vlera e investimeve për krijimin e Parkut është 5,921,517.00 EUR. Këto investime janë bërë nga Zyra e Bashkimit European, MTI, komuna e Mitrovicës, si dhe organizatat biznesore që janë shfrytëzuese të Parkut.

Kontratat për shfrytëzimin e Parkut ishin bërë me Bizneset gjatë viteve 2004-2006 për periudhë kohore 10-vjeçare. Afati i këtyre kontratave tashmë ka kaluar (në vitet 2014-2016), dhe aktualisht organizatat biznesore të vendosura në Park e shfrytëzojnë atë pa kontratë formale, gjë që paraqet problem ligjor, financiar (nuk paguhen qiratë) dhe operativ (disa biznese nuk ushtrojnë veprimtarinë ekonomike).

Problemi qëndron në faktin se një pjesë e Parkut – në sipërfaqe 0.84,53 ha – shtrihet në **pasurinë ujore me numër të fletës poseduese 3305**.

Prandaj kërkesa e komunës së Mitrovicës e parashtruar më datë 17/11/2022 drejtuar Kryeministrit të Kosovës në cilësinë e tij si Kryesues i Këshillit Ndërministror për Ujëra është ‘që të **lejohej shfrytëzimi i parcelës tokësore e cila është pasuri ujore për nevojat e Parkut**’.

Shqyrtimi i lëndës së Parkut të Biznesit ka përfshirë (i) shqyrtimin e dokumentacionit të vënë dispozicion nga komuna e Mitrovicës si dhe të dhënave tjera kadastrale në kontekst të legjislacionit në fuqi, (ii) daljen në terren me qëllim të kryerjes së matjeve dhe verifikimit të gjendjes faktike, dhe (iii) analiza hidrologjike dhe hidraulike në funksion të analizimit të kufijve të pasurisë ujore dhe ndikimeve potenciale të ujërave të mëdha në sigurinë e objekteve rreth pasurisë ujore.

Gjetjet nga shqyrtimi i lëndës janë dhënë në vazhdim të këtij raporti.

3.2 Shtrirja hapësinore e lokacionit lëndor

Lokacioni i parcelës tematike të pasurisë ujore në aspektin administrativ shtrihet në territorin e komunës së Mitrovicës, e cila shtrihet në pjesën veriore të Kosovës.

Ne kontekst makro-hapësinor hidrografik, lokacioni ne shqyrtim shtrihet ne segmentin e lumit Sitnica-ne pjesën ne mes grykëderdhjes se lumit Sitnica ne lumin Iber dhe grykëderdhjes se lumit Trepça ne lumin Sitnica. Lumi Trepça është nenpellg i pellgut te lumit Sitnica , kurse lumi Sitnica është nenpellg i pellgut te lumit Iber.

Ne aspektin hidrologjik profili hidrologjik tematik i lumit është pjese e pellgut ujore te lumit Sitnica. Skemat shtrirjes paraqitet ne figurën vijuese ne begrand te Hartës Topografike te Kosove 1:25 000.

Skema është ilustruar edhe me dy profile hidrologjike lumore te lumit Sitnica me simbole te ‘vize-vize’ me ngjyre te kuqe si ne vijim.




Figura 3-1: Shtrirja makro-hapësinore e Parkut te Biznesit ne Mitrovicë

Nga figura e mësipërme duket qarte se segmenti lumore tematik meandrin si ne pjesën e sipërme te ujerrjedhes e po ashtu edhe ne pjesën e poshtme te ujerrjedhes, meandrimet këto te cilat kane rol te përfillshim ne aspektin e bartjes se aluvioneve dhe ngadalësimit te shpjetesesisë se ujerrjedhes me rastin e plotave te lumit.

Lokacioni i 'Parku i Biznesit ne Mitrovicë' ne aspektin mikro-hapësinor e ne sfond te 'Ortofoto 2018 te Republikës se Kosovës' paraqitet si ne figurën vijuese.



Figura 3-2: Shtirirja mikro-hapësinore e lokacionit te 'Parkut te Biznesit ne Mitrovicë'

3.3 Analiza/Gjetjet

3.3.1 Gjendja kadastrale tematike

Nga baza e te dhënave ne disponim nga SI (sistemit Informativ) ne ARPL te pranuar zyrtarisht përmes protokollit lidhur me parcelat kadastrale ne segmentin tematik te lumit Sitnica, ne sfond te 'Ortofotove te Kosovës 2018' paraqitet dispozita e parcelave kadastrale si ne figurën vijuese.




Figura 3-3: Skema tematike e kërkesës se Komunës se Mitrovicës.

Për faktin se sipas Vendimit për dhënien ne shfrytëzim te tokës ndërtimore me qëllim te implementimit te projektit “Parku i Bizneseve” i lëshuar nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës me datë 24.02.206, rezulton se :

Vendimi ne fjalë i KK Mitrovicë (paragrafi 1.b) ka **tjetërsuar** statusin e një pjese te parcelës 03548-1 nga statusi i përcaktuar me Fletë poseduese Nr. 3305 si pronë shoqërore (te mirat publike te ujërave) ne tokë ndërtimore, ne kundërshtim me Nenin 110.3 te Ligjit për Ujërat e Kosovës, GPJ kërkuar nga AKK informatë shtesë lidhur me çështjen.

Me datë 28. 03. 2023, lidhur me çështjen e parcelës 03548-1, është pranuar ne email te anëtarit te GPJ përgjigja si ne vijim:

Përgjigja nga AKK/z. Demir Hyseni (email zyrtar), datë 28.03.2023

I/E Nderuar

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka pranuar kërkesën nga Udhëheqësi të Divizionit te Ujërave-MMPHI lidhur me parcelën me numër 3548-1 e cila gjendet në ZK Mitrovicë Komuna Mitrovicë.

Pas analizimit te kërkesë lidhur me parcelën me numër 3548-1 kemi konstatuar se kjo parcele është ndarë në vitin 2015 nga ZKK Mitrovicë me kërkesë të Kuvendit Komunal Mitrovicë dhe janë krijuar parcelat e reja me numër 3548-11, 3548-12, 3548-13 dhe 3548-14 te cilat janë ndare ne pjesën tekstuale ndërsa ne pjesën grafike (Hartë Kadastrale) këto parcela mungoj, është me mbetur parcela bazë me numër **3548-1**.

Andaj kërkojmë nga ZKK Mitrovicë te beje azhurnimin/ndarjet e parcelave te cilat janë krijuar nga ndarja e parcelës 3548-1 ZK Mitrovicë

Gjithashtu nga kërkesa e drejtorisë përkatëse të komunës Mitrovicës adresuar MMPHI me 17.03 2022 lidhur me lëshim të Pëlqimit për shfrytëzimin e hapësirave për rreth lumit Sitnica, respektivisht menaxhimin e tyre (shfrytëzim, mirëmbajtje dhe ruajtje), i është bashkëngjitur skema tematike vijuese.



Figura 3-4: Skema tematike e kërkesës së Komunës së Mitrovicës.

3.3.2 Studimi shkurtër hidrologjik

Për faktin se Pasuria ujore e ujerave rrjedhëse është shtrati i ujerrjedhes dhe brezit bregudor (Neni 4.2 UA Statusi Pasurisë Ujore), e për faktin se shtratin meritohet të ujerave- Shtratin e ujerave të mëdha që paraqet "Shtratin e ujerrjedhes të dimensionuar për ujera me periudhë kthyesë 100-vjeqare" (Neni 3/1.6 të UA Nr. 05/2016 Për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore), rezulton detyrimi i përcaktimit të prurjeve maksimale me probabilitet P1%. Në kuadër të kësaj paraqitet skema hidrologjike e pellgjeve tematike në raport me Stacionin Hidrometrik Referent Nedakoc dhe sipërfaqet e tyre.




Figura 3-5: Skema hidrologjike e pellgjeve lëndore

Për faktin se si stacion hidrometrik referues është kualifikuar St. Hidrometrik Nedakoc (2590 km²), nga të dhënat e IHMK për prurjet ditore të serisë kronologjike 1963-1985 (21 vite) janë përpunuar fillimisht ato të (i) prurjeve maksimale mujore e si rezultat i këtyre të fundit edhe (ii) prurjet maksimale vjetore të serisë përkatëse, pas aplikimit të metodave empiriko/teorike, kanë rezultuar rezultatet vijuese sipas Metodës Gumbel (Met. Tipike Standarde) :




Figura 3-6: Q1% sipas Met.Gumbel

Në vijim paraqiten rezultate nga burime tjera ne kontekst te Q1% për Stacionin Hidrometrik Nedakoc.

- 1) Projekti "REPOWER-Kosovo / Draft Micro-location Flood Risk Assessment Study For New Kosovo Power Plant",

ne Tabelën 3.2, paraqet te dhënat vijuese:

Tabela 3-1: Probabiliti i prurjeve maksimale për periudha kthyes ne St. Hidrometrik Nedakoc

Table 3.2-22: Probability of occurrence of maximum annual discharges

RP (year)	PROBABILITY (%)	PROBABILITY OF OCCURRENCE OF MAXIMUM ANNUAL DISCHARGES (m ³ /s)		
		DRENAS	MILLOSHEVË	NEDAKOVIC
1000	0.1	177.7	354.3	623.8
100	1	112.2	217.8	436.4
50	2	95.26	183.1	384.1
25	5	79.38	150.9	333.4
10	10	59.86	111.9	267.7
Selected distribution		GALTON	GALTON	GALTON
Analyzed period		1963-1985	1963-1985	1963-1985

- 2) Projekti Kryesor i 'Rregullimit të lumit Sitnica /Segmenti Parku i Biznesit, Mitrovicë' te dërguara si informatë tematike me datë 07.07.2023 për komunën e Mitrovicës.

E dhëna $Q_{MAX}=239.76 \text{ m}^3/\text{s}$ e përvetësuar për dimensionimin e shtratit të rregullimit të lumit nuk korrespondon as për se afërmi me prurjen meritorë formale me probabilitet 1% për vendet urbane.

Tabela 3-2: Ekstrakt i Q_{max} nga Projekti Kryesor Rregullimit të Lumit Sitnica

Ekstrakt i Tab. nga Projekti Kryesor 'Rregullimi Lumit Sitnica'/Segmenti Parku i Biznesit ne Mitrovicë	
INFORMATAT BAZIKE PER KALKULIME HIDRAULIKE	
Input Data	
Slope	0.1000 %
Water Surface Elevation	3.80 m
Results	
Mannings Coefficient	0.035
Elevation Range	0.00 to 4.00
Discharge	239.7668 m^3/s ... ?
Flow Area	130.9 m^2
Wetted Perimeter	44.45 m
Top Width	42.50 m
Actual Depth	3.80 m
Critical Elevation	1.97 m
Critical Slope	1.0653 %
Velocity	1.83 m/s
Velocity Head	0.17 m
Specific Energy	3.97 m
Froude Number	0.33
Flow Type	Subcritical

PS: Te dhena nga IHMK St.Nedakoc:
 1963:Hmax=358; Qmax=328 m^3/s
 1979:Hmax=3410; Qmax= ? m^3/s
 PS: Te dhena nga Baza H.Ekon/Srbi:
 Q1%=482.2 m^3/s
 Gabimi:
 482.2/239.7= 2.011
 ose ...100 %

Nga tri te dhënat për Q_{MAX} ne paragrafët paraprak, rezulton se 'Seksioni tërthor i shtratit të lumit' nga Projekti Kryesor i Rregullimit të Lumit, duhet riprojektuar (ridizajnuar) sipas Q1% meritorë, qe rezulton nga te dhënat rezultuese sipas metodave standarde të llogarisë probabiliteteve për Q1% nga te cilat përvetësohet rezultatit me i përshtatshëm i tyre ne raport me ndonjërin nga Testet standarde të përshtatshmërisë.

Duhet të potencohet se $Q_{MAX}=239.76 \text{ m}^3/\text{s}$ e aplikuar ne Projektin Kryesor të Rregullimit të Lumit Sitnica ne Segmentin Parku i Biznesit, është me shkallë të pasaktësisë rreth 100%, dhe si e tillë nuk është meritorë për dimensionimin e kanaleve ne vendet urbane.

3.3.3 Modelimi hidraulik i zonës vërshuese me HEC-RAS

Bazuar ne te dhënat meritorë hidrologjike ne seksionin paraprak, dhe bazuar ne te dhënat gjeomorfologjike te fituar nga incizimi me 'DRON' përmes softit HEC-RAS 6.3.1 është realizuar modeli hidraulik. Ne vijim paraqiten Orto-fotoja dhe DTM i zonës se Parkut te Biznesit ne Mitrovice nga incizimi me 'Dron' te SI te ARPL me date 18.01.2023.

Ne figurën vijues paraqitet 'Orto-Foto' e realizuar me 'Dron' te SI te ARPL me date 18.01.2023.



Figura 3-7: Orto-Foto me DRON e Parkut Biznesit Mitrovicë, më 18.01.23

Nga Orto-Foto shihet qartë shtrirja e Parakut te Biznesit ne Mitrovicë ne anën e majtë te ujë rrjedhës se lumit Sitnica, i cili ne jug-lindje kufizohet me rrugë lokale përgjatë bregut te majtë te lumit Sitnica, ne perëndim kufizohet me një rrugë lokale tjetër ne veri gjithashtu.

Gjithashtu, vërehet se buzë ujërrjedhës (përtej argjinaturës nga ana lumore) ka disa ndërtime te objekteve afariste, te cilat ne aspektin rregullativ te fushës se mbrojtjes nga veprimet e dëmshme te ujërave janë një absurd i llojit rregullativ e profesional.

Objektet e theksuara ne paragrafin paraprak ne aspektin e legjislacionit te ujërave trajtohen si objekte joformale, problematika e te cilave sipas praktikave regjionale duhet zgjidhur përmes procedurave legalizuese ligjore.

Ne figurën vijues DTM ('digital terrain model'), si rezultat i incizimit me 'Dron' te SI te ARPL me date 18.01.2023.




Figura 3-8: DTM i Parkut Biznesit Mitrovicë, datë 18.01.23

Ne vijim paraqitet regjimi jo-stacionar i ngarkesës hidrologjike për Q1% sipas skenarit të regjimit vërshues-hidrogramit si ne vijim, si rezultat i të cilit pasojnë rezultatet llogaritave të parametrave të zonës vërshuese të paraqitura ne vijim.




Figura 3-9: Hidrogrami i skenarit vërshues

Ne harmoni me Nenin 7/3 te UA MMPH Nr.19/2015 për Mbrojtje nga Veprimet e Dëmshme te Ujërave lidhur me zonat e vërshimit kërkohet:

Neni 7.3. Për secilin prej skenarëve nga paragrafi 2 i këtij neni duhet te paraqiten elementet si vijon:

- 3.1 Hapësira e vërshimit;
- 3.2 Thellësia e ujit ose niveli i ujit, cilado qe është me e përshtatshme;
- 3.3 shpejtësia e vërshimit ose prurja relevante e ujit ,sipas rastit

Shënim:

Pra kufirit te pasurive ujore, i paraprin përcaktimi i hapësirës se vërshimit, thellësisë se ujit e niveleve, shpejtësia e vërshimit dhe prurja maksimale meritorë . Pas përcaktimi te hapësirës vërshuese (shtratit te madh 100 vj. aplikohet brezi bregudorë , e tani te dyja se bashku përbejnë sipërfaqen e pasurisë ujore .

Ne harmoni me kriteret e Nenit 7.3 te UA MMPH Nr.19/2015 për Mbrojtje nga Veprimet e Dëmshme te Ujërave ne vijim paraqiten rezultatet e modelit hidraulik te thellësive se zonës vërshues për prurjen maksimale me periudhe kthyesse $T=100$ vj.




Figura 3-10: Thellësitë e zonës vërshuese

Me qëllim te validimit te modelit hidraulik llogaritar për Q1% sipas hidrogramit meritor, ne vijim paraqitet një foto e vërshimeve te vërteta te zonës ne fjalë me datë 13.01.2021 nga ku vërehet shtrirje e ngjashme e zonës vërshuese me atë të modelit hidraulik.

Gjithashtu, ne vijim paraqitet rezultati i modelit hidraulik lidhur me shpejtësitë e lëvizjes se ujit për Q1% ne zonën vërshuese.




Figura 3-11: Modeli i shpejtësive ne zonën vërshuese




Figura 3-12: Modeli i lartësive mbidetare ne zonën vërshuese

Me qëllim të kalibrimit të modelit hidraulik llogaritar për Q1% sipas hidrogramit merit, ne vijim paraqite një foto e vërshimeve të vërteta të zonës në fjale me datë 13.01.2021 nga ku vërehet se rezultatet dalëse të modelit hidraulik i përgjigjen të dhënave vrojtues të vërshimeve .

Fotoja kalibruese e modelit hidraulik paraqitet në figurën vijuese.



Pamje pas vërshimeve nga Lumi Sitnica, Mitrovicë 13.01.2021

Skender Maloku Photographer
303 subscribers

Subscribe

6

Share

Download

Clip

Save

...

Figura 3-13: Foto e vërshimeve të zonës Parku i Biznesit, datë 13.01.2021

3.3.4 Përcaktimi i kufijve të pasurisë ujore

Harta vërshuese ('Inundation Map'), rezultat i modelit hidraulik: 2D-Flow me RAS-MAPPER(HEC-RAS), bartet në Arc-GIS format (.shp file), me qëllim të standardizimit formal të paraqitjes së sipërfaqes vërshuese si në figurën vijuese:




Figura 3-14: Harta e zonës vërshuese ne zonën e Parkut Biznesit ne Mitrovicë

Nga harta e zonës vërshuese e paraqitur me lartë, konstatohet se gjatë skenarit vërshues te plotës me periudhë kthyesë 100-vjeqare, uji duke dalur nga shtrati vërshon sipërfaqet për rreth, duke formuar një sipërfaqe gjeometrikisht te parregullt vërshuese, si pasojë e ndërtimeve brenda sipërfaqes ne fjalë.

Ne harmoni me Nenin 4 te UA (MMPH) Nr.05/2016 për Rregullimin e Statusit te Pasurisë Ujore, definimin "Pasuria ujore e ujerave rrjedhëse është shtrati i ujerrjedhes dhe **brezit bregujor**" dhe definimin "Brezi bregujor është brezi tokësor i ngjitur me shtratin e ujerrjedhes...", kriterin e gjerësisë se brezit bregujor prej 10 metrave për ujerat e mëdha ne zonat urbane, bëhet ripërcaktimi i kufijve te pasurisë ujore bazuar ne rezultat e sipërfaqes vërshuese sipas modelimit me Ras Mapper(HEC-RAS).

Rezultati llogaritar i përcaktimit te '**brezit bregujor**' buzë perimetrit te sipërfaqes vërshuese gjeometrikisht te parregullt (harta ne figurën paraprake), përfshi edhe vetë sipërfaqen e theksuar paraqitet ne figurën vijuese.




Figura 3-15: Sipërfaqja vërshuese për Q1% dhe brezi bregujor me gjerësi 10 m.

Nga harta e sipërme - Harta e sipërfaqes vërshuese Q1% bashkë me brezin bregujor 10 m¹, konstatohet edhe forma gjeometrikisht e parregullt e brezit bregujor, e cila është pasojë e formës gjeometrikisht të parregullt e perimetrit të sipërfaqes vërshuese, e cila gjithashtu është pasojë e ndërtimeve të objekteve jo-ujore, të cilat deri në trajtimin e tyre sipas procedurave legjislative të legalizimeve, cilësohen si objekte jo-formale në aspektin e legjislacionit të ujërave.

Integrimi i hartës paraprake – Hartës së sipërfaqes vërshuese të kufizuar me brez bregujor të gjerësisë 10 metra, në sfond të gjendjes së parcelave kadastrale, mundëson qartësimin hapësinor të sipërfaqes vërshuese në lokacionin Parku i Biznesit, respektivisht statusin e pasurisë ujore në 'pasuri ujore publike' dhe 'pasuri ujore private'.

Në figurën vijues paraqitet harta - Sipërfaqja vërshuese Q1% bashkë me brezin bregujor në gjerësi 10 metra, në sfond të gjendjes kadastrale aktuale.




Figura 3-16: Brezi bregujor i llogaritur ne sfond te parcelave kadastrale.

Nga harta e mësipërme - Harta e sipërfaqja vërshuese Q1% bashke me brezin bregujor 10 m' mbi sfondin gjendjes kadastrale aktuale, konstatohet statusi 'pasurisë ujore publike' i parcelave kadastrale: 03548-2, 03548-1, 09290-0 e 03548-10 (parcelat e hijezuara me ngjyrë te kaltër).

Gjithashtu, ne hartën paraprake, ne bazë te dhënave të disponueshme te SIU/ARPL/MMPHI te pranuar formalisht nga AKK, paraqiten janë paraqitur edhe grafika e parcelave tematike për rreth parcelave me status te 'pasurive ujore publike'. Për faktin se riparcelizimi, regjistrimi i pasurive ujore ne Kadastër dhe në Regjistrin e te Drejtave te Pronës se Paluajtshme (Ligji i Regjistrimit te Paluajtshmerive/2008) kadastër e regjistër te paluejtshmërive, formalisht kërkon involvimin e gjeometrit te licencuar sipas legjislacionit te Kosovës, statusi i pronave jopublike për rreth 'pasurive ujore publike' integrohet nga ana e gjeometrit gjatë proceseve te theksuara paraprakisht.

Për faktin se forma gjeomerikisht e parregullt e perimetrit te brezeve bregujore, e duke pasur parasysh se kufiri i pasurisë ujore duhet jetë poligon i rregullt e praktik ne Sistemin Koordinativ *KosovaRef* (në shkallë së paku 1:5000), rezulton nevoja për ri-rregullim praktik e profesionale te kufirit te pasurisë ujore.

Në rastin konkret në harmoni me situatën kadastrale të 'pasurisë ujore publike' (parcelat: 03548-2, 03548-1, 09290-0 e 03548-10) dhe ndërhyrjen e 'brezit bregudor' në to, në funksion të parimit integruar të parcelave dhe ruajtjes së pasurisë ujore publike, rezultojnë nevojat e përcaktimit të poligonit mbështjellës ('anvelope') të brezave bregudorë jashtë 'sipërfaqeve të pasurive ujore publike', i cili në integrim me këto të fundit, rezultojnë sipërfaqet shtesë të pasurisë ujore në dy anët e ujërrjedhës si në figurën vijuese.




Figura 3-17: Brezit bregudor llogaritur mbi sfondin e parcelave kadastrale.

Nga harta e mësipërme qartësohet se kufiri aktual kadastral i pasurisë ujore – kufiri i pasurive aktuale të 'pasurive ujore publike' – zgjerohet majtas e djathtas ujërrjedhës me sipërfaqe prej 24608 m² (majtas) dhe 32739 m² (djathtas) sipas vijave poligonale me koordinatat e pikave poligonale të paraqitura në tabelën vijues.

Në vijim paraqiten koordinatat e pikave poligonale të sipërfaqeve poligonale të shtuara të pasurisë ujore në Sistemin Koordinativ *KosovaRef*.

Tabela 3-3: Kordinata e pikave poligonale

Pik.Polig.Pas.Ujore					
	FID	Shape *	Id	Xcord	Ycord
▶	0	Point	0	7490020	4750290
	1	Point	0	7490010	4750310
	2	Point	0	7490020	4750360
	3	Point	0	7490140	4750460
	4	Point	0	7490220	4750500
	5	Point	0	7490320	4750480
	6	Point	0	7490390	4750510
	7	Point	0	7490400	4750500
	8	Point	0	7490420	4750440
	9	Point	0	7490430	4750430
	10	Point	0	7490440	4750420
	11	Point	0	7490400	4750350
	12	Point	0	7490350	4750220
	13	Point	0	7490280	4750160
	14	Point	0	7490110	4750140
	15	Point	0	7490080	4750180

3.4 Konkluzionet lëndore

Bazuar në kriteret e përcaktuara ligjore si dhe në gjetjet e prezantuara në seksionet paraprake të këtij raporti, mund të nxjerren konkluzionet vijuese:

- 1) Statusi i pasurisë publike ujore në zonën e Parkut të Biznesit në Mitrovicë është tjetërsuar kundërligjshëm nga Kuvendi Komunal i Mitrovicës në tokë ndërtimore.
- 2) Zgjidhja projektuese e rregullimit të lumit Sitnica ne segmentin e lokacionit te ‘Parkut te Biznesit ne Mitrovicë’ me ‘Projektin Kryesor te Rregullimit te Lumit Sitnica’, duhet të ridizajnohet dhe me këtë rast duhet të bazohet në një studim cilësor hidrologjik si dhe në kriteret e avancuar të rregullimit natyror te lumenjve. Kjo sepse me këtë projekt është kalkuluar dhe përvehtësuar gabimisht parametri hyrës hidrologjik – *Prurjes maksimale hidrologjike* në vlerë $Q=239,76 \text{ m}^3/\text{s}$ (që sipas kalkulimeve të kryera nga GPJ është rreth 100% me e vogël se $Q_{1\%}$ meritore).
- 3) Ndërtimet ne lokacionin e pasurise ujore publike ashtu siç është në kufijtë aktual, pavarësisht vendimeve tjetërsuese te konvertimit te pasurive ujore publike ujore ne tokë ndërtimore, sipas legjislacionit pozitiv te fushës se ujërave, konsiderohen ndërtime jo-formale, dhe te njëjtat duhet ritrajtuar ne harmoni me procedurat e legalizimit sipas legjislacionit përkatës brenda afatit prej 2-viteve.
- 4) Ne harmoni me Nenin 13 te *UA MMPH Nr.05/2016 për Rregullimin e Statusit te Pasurisë Ujore*, përgjegjësia e menaxhimit te pasurisë publike ujore përfshirë edhe parcelën tematike 03548-1 te ZK. Mitrovicë (zone urbane) është përgjegjësi e Komunës se Mitrovicës.
- 5) Për ‘Parkun e Biznesit ne Mitrovicë’ MMPH ka lëshuar Pëlqimin Mjedisor me NR.12/1465/1-ZSP-159/12, datë 16.08.2012, lëshim i cili kishte ndikim ne realizimin e te drejtave ne harmoni me legjislacionin pozitiv mjedisore.

3.5 Rekomandimet lëndore

Duke pasur parasysh faktin se:

- (a) zona e ‘Parkut te Biznesit ne Mitrovicë’ është në harmoni me dokumentet planifikuese zyrtare (PZHK) të Komunës se Mitrovicës i aprovuar nga MMPHI,
- (b) projekti ‘Parku i Biznesit në Mitrovicë’ është i aprovuar edhe nga MMPHI përmes Pëlqimit Mjedisor të lëdhuar nga kjo Ministri,
- (c) të drejtat e realizimit bazohen në legjislacionet tjera përkatëse,

(d) Zona në fjalë është e rrezikuar nga përmbytjet e shpeshta,

rekomandohet që:

- 1) MMPHI ne bashkëpunim me komunën e Mitrovicës, të planifikojnë realizimin e një projekti kapital për 'Rregullimin me restaurim te lumit Sitnica ne segmentin pranë lokacionit te 'Parkut te Biznesit ne Mitrovicë';
- 2) Pas rregullimit të seksionit të lumit Sitnica siç rekomandohet në pikën 1) më sipër, të përcaktohen kufijtë e pasurisë ujore në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm (që aktualisht përfshin brezin prej 10 metrave prej kufirit të strukturave mbrojtëse/rregulluese të lumit për ujërat e mëdha);
- 3) Pas përcaktimit të kufirit të pasurisë publike ujore sipas rekomandimit në pikën 2) më sipër, mund të ndërmerren veprimet e duhura administrative dhe ligjore për rregullimin statusit të pronës tokësore jashtë kufirit të pasurisë ujore të përcaktuar (ndërprerja e statusit të pasurisë ujore, dhënia në shfrytëzim e kësaj prone komunës së Mitrovicës etj.).

4. Lënda: GLAREVA SH.P.K

4.1 Sfondi/përshkrimi i kërkesës/metodologjia shqyrtuese

“Gllareva” sh.p.k., me Numër Unik Identifikues 811281865, me adresë: fshati Gllarevë p.n., komuna e Klinës, të cilën e përfaqëson Genc Morina si përfaqësues ligjor, përmes aplikacionit me numër të protokollit 716/2, datë 16.02.2022 për ARPL/MMPHI ka paraqitur kërkesë me subjektin vijues:

Lënda: Kërkesë për lejimin e kthimit të rrjedhës së lumit Graçankë në shtratin origjinal të lumit, sipas Kopjes së Planit datë 30.12.2021 ZKK Fushë Kosovë të Ngatrës Kadastrale P-72514011-00575-0, Zona Kadastrale Vragoli, Komuna e Fushë Kosovës.

Kërkesës i është bashkëngjitur kopja e planit të ngatrës kadastrale lëndore, lëshuar nga ZKK në Fushë Kosovë.

Në kuadër të kërkesës lëndore është sqaruar se, sipas Kopjes së Planit bashkëngjitur kërkesës, lumi Graçanka rrjedh pranë ngatrës kadastrale P-72514011-00575-0, Zona Kadastrale Vragoli, Komuna e Fushë Kosovës, përderisa në gjendjen faktike, lumi në fjalë përshkon përmes ngatrës kadastrale tematike, në të cilën është i vendosur objekti i veprimtarisë afariste të Gllareva Sh.p.k.

Në kuadër të kësaj për nevojë të ekonomizimit të parcelës lëndore, është kërkuar kthimi i ujerrjedhës në gjendjen e mëparshme-gjendjen e paraqitur në planin kadastral të ngatrës.

Shqyrtimi i lëndës së Parkut të Biznesit ka përfshirë (i) shqyrtimin e dokumentacionit të vënë dispozicion nga komuna e Mitrovicës si dhe të dhënave tjera kadastrale në kontekst të legjislacionit në fuqi, (ii) daljen në terren me qëllim të kryerjes së matjeve dhe verifikimit të gjendjes faktike, dhe (iii) analiza hidrologjike dhe hidraulike në funksion të analizimit të kufijve të pasurisë ujore dhe ndikimeve potenciale të ujërave të mëdha në sigurinë e objekteve rreth pasurisë ujore.

Gjetjet nga shqyrtimi i lëndës janë dhënë në vazhdim të këtij raporti.

4.2 Shtrirja hapësinore e lokacionit lëndor

Lokacioni i parcelës tematike të pasurisë ujore në aspektin administrativ shtrihet në territorin e Zona Kadastrale Vragoli, Komuna e Fushë Kosovës.

Në kontekst makro-hapësinor hidrografik, lokacioni në shqyrtim shtrihet në segmentin e lumit Graçanka, pranë grykëderdhjes së këtij lumi në lumin Sitnica.

Në aspektin hidrologjik, profili hidrologjik tematik i lumit është pjesë e pellgut ujor të lumit Graçanka. Skema e shtrirjes paraqitet në figurën vijuese në sfond të Hartës Topografike të Kosovës në përpjesë 1:25 000.

Në vijim, në aspektin makro-hapësinor paraqitet ne sfond topografik skema e segmentit që është objekt i këtij raporti me objektet për rreth, përfshirë edhe objektin e “Gllareva “ Sh.p.k ne anën e majtë te lumit Graçanka si në figurën vijuese.




Figura 4-1: Shtrirja makro-hapësinore e segmentit te lumit Graçanka

Nga figura e mësipërme duket qartë se segmenti lumor tematik shtrihet ne fund të lumit Graçanka, në afërsi të grykëderdhjes ne lumin Sitnica, ne zonën ku këtij te fundit nga ana e majtë i bashkohet lumi Drenica kurse nga ana e djathtë lumi Prishtevka.

Lokacioni i segmentit lumit Graçanka që është objekt trajtimi i këtij raporti, ne kontekst kadastral/parcelave kadastrale tematike ne sfond te hartave Orto-foto 2018 te Kosovës, paraqitet si në figurën vijuese.




Figura 4-2: Shtirja mikro-hapesinore e lokacionit te 'Parkut te Biznesit ne Mitrovice'

4.3 Analiza/Gjetjet

4.3.1 Gjendja kadastrale tematike

Nga baza e te dhënave ne dispozicion nga SIU i ARPL te siguruar përmes pranimi formal protokollar nga AKK, ne sfond hartave 'Orto-foto te Kosovës 2018' paraqitet dispozita e parcelave kadastrale tematike, me hijezim te veçantë te parcelës lëndore 00575-0 (me ngjyrë vjollcë) ne pronësi te "Gllareva" Sh.p.k. ne raport me 'pasurinë ujore publike kadastrale' të hijezuar me ngjyrë ta kaltër si ne vijim.




Figura 4-3: Skema pasurisë publike ujore kadastrale në raport me parcelën në pronësi të "Gllarea" sh.p.k.

Parcela me nr. 00197-18/Vragoli është në pronësi të "TRUCK TRANS" L.L.C. me sipërfaqe të përgjithshme $S=292m^2$ (ndarja e parcelës është kryer në vitin 2013 prej ndarjes së parcelës 197-1)

4.3.2 Studimi shkurtër hidrologjik

Për faktin se pasuria ujore e ujërave rrjedhëse është shtrati i ujërrjedhës dhe brezi bregudor (Neni 4.2 i UA për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore), e duke pasur parasysh se shtrati i ujërave të mëdha si bazë për përcaktimin e pasurisë ujore përkufizohet si "shtrati i ujërrjedhës i dimensionuar për ujëra me periudhë kthyesë 100-vjeçare" (Neni 3/1.6 i UA Nr. 05/2016 për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore), rezulton detyrimi i përcaktimit të prurjeve maksimale me probabilitet P1%. Në kuadër të kësaj paraqitet skema hidrologjike e pellgjeve tematike në raport me Stacioni Hidrometrik Referent Nedakoc dhe sipërfaqet e tyre.




Figura 4-4:Skema hidrologjike e pellgjeve lëndore

Për faktin se profili hidrologjik meritor i segmentit lumor tematik të lumit Graçanka shtrihet drejtpërdrejt në grykëderdhjen e lumit Sitnica me St.Hidrometrik Nedakoc si stacion përfaqësues i cili u studiua në rastin lëndor paraprak "Parku i Biznesit në Mitrovicë", rezulton se i njëjti stacion hidrometrik kualifikohet si meritor edhe për pellgun e lumit Graçanka.

Të dhënat hidrologjike (Q1%) të St.Hidrometrik Nedakoc, transpozohen në profilin hidrologjik tematik të lumit Graçanka sipas metodologjisë së projektit: "Projekti "REPOWER-Kosovo / Draft Micro-location Flood Risk Assessment Study For New Kosovo Power Plant" i vitit 2017, me hidrogramin si në vijim:




FIGURE 3.2-16: FLOOD WAVES OF 50- AND 100-YEAR RECURRENCE PERIOD AT THE MOUTH OF THE GRAÇANICA INTO THE SITNICA RIVER

Figura 4-5: Hidrogrami lumit Graçanka

4.3.3 Modelimi hidraulik i zonës vërshuese me HEC-RAS

Bazuar ne Q1% nga seksioni paraprak, te dhënat nga plani i situacionit ne figurën vijuese, përmes programit softuerik *HEC-RAS 6.3.1*, është realizuar modeli hidraulik i segmentit te lumit Graçanka përgjatë lokacionit te “Gllareva” sh.p.k.




Figura 4-6: Plani i Situacionit 'Gllareva' Sh.p.k

Ne vijim paraqitet modeli i terrenit (DTM) të lokacionit "Gllareva" sh.p.k. i përfituar nga te dhënat e 'Planit te Situacionit' në figurën paraprake përmes 'Autocad Civil 3D' dhe hidrogrami Q1% i profilit hyrës te segmentit lumor te lokacionit tematik te lumit Graçanka




Figura 4-7: DTM i 'Gllareva'Sh.p.k




Figura 4-8: Hidrogrami i skenarit vërshtues

Ne harmoni me Nenin 7/3 te UA MMPH Nr.19/2015 për Mbrojtje nga Veprimet e Dëmshme te Ujërave lidhur me zonat e vërsimit kërkohet:

Neni 7.3. Për secilin prej skenarëve nga paragrafi 2 i këtij neni duhet të paraqiten elementet si vijon:

- 3.1 Hapësira e vërshimit;
- 3.2 Thellësia e ujit ose niveli i ujit, cilado që është me e përshtatshme;
- 3.3 Shpejtësia e vërshimit ose prurja relevante e ujit, sipas rastit

Shënim:

Pra kufirit të pasurive ujore, i paraprin përcaktimi i hapësirës së vërshimit, thellësisë së ujit e niveleve, shpejtësia e vërshimit dhe prurja maksimale meritorë. Pas përcaktimit të hapësirës vërshuese (shtratit të madh për prurje 100-vjeçare, përcaktohet brezi bregujor, dhe të dyja së bashku përbëjnë sipërfaqen e pasurisë ujore.

Ne harmoni me kriteret e Nenit 7.3 të UA MMPH Nr.19/2015 për Mbrojtje nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave, ne vijim paraqiten rezultatet e modelit hidraulik të thellësive të zonës vërshuese për prurjen maksimale me periudhë kthyesë $T=100$ vjeçare.




Figura 4-9:Thellësitë e zonës vërshuese

Me qëllim të validimit të modelit hidraulik llogaritar për $Q_{1\%}$ sipas hidrogramit meritor, në vijim paraqitet një foto e vërshimeve të vërteta të zonës në fjalë që ka ndodhur më datë 13.01.2021 nga ku vërehet shtrirje e ngjashme e zonës vërshuese me atë të modelit hidraulik.

Gjithashtu, ne vijim paraqitet rezultati i modelit hidraulik lidhur me shpejtësitë e lëvizjes së ujit për $Q_{1\%}$ në zonën vërshuese dhe modeli i niveleve të lartësive mbidetare të ujit në skenarin vërshues.




Figura 4-10: Modeli i shpejtësive dhe niveleve ne zonën vërshuese

4.3.4 Përcaktimi i kufijve të pasurisë ujore

Harta vërshuese ('Inundation Map'), rezultat i modelit hidraulik: 2D-Flow me RAS-MAPPER(HEC-RAS), bartet ne Arc-GIS format (.shp file), me qëllim te standardizimit formal të paraqitjes se sipërfaqes vërshuese si ne figurën vijuese:




Figura 4-11: Harta e zonës vërshuese tematike

Nga harta e zonës vërshuese e paraqitur me lartë, konstatohet se gjatë skenarit vërshues te plotës me periudhë kthyesë 100-vjeçare, uji duke dalur nga shtrati vërshon sipërfaqet për rreth, duke formuar një sipërfaqe gjeometrikisht te parregullt vërshuese, si pasojë e ndërtimeve brenda sipërfaqes ne fjalë.

Ne harmoni me Nenin 4 te UA (MMPH) Nr.05/2016 për Rregullimin e Statusit te Pasurisë Ujore, dhe përkufizimin në këtë UA se "Pasuria ujore e ujërave rrjedhëse është shtrati i ujërrjedhës dhe **brezi bregujor**" si dhe përkufizimin se "Brezi bregujor është brezi tokësor i ngjitur me shtratin e ujërrjedhës...", kriterin e gjerësisë se brezit bregujor prej 5 metrave për ujërat e mëdha ne zonat jo-urbane, bëhet ripërcaktimi i kufijve te pasurisë ujore bazuar ne rezultat e sipërfaqes vërshuese sipas modelimit me *Ras Mapper(HEC-RAS)*.

Rezultati llogaritar i përcaktimit te '**brezit bregujor**' buzë perimetrit te sipërfaqes vërshuese gjeometrikisht te parregullt (harta ne figurën paraprake), përfshi edhe vetë sipërfaqen e theksuar paraqitet ne figurën vijuese.



Figura 4-12: Sipërfaqja vërshuese për Q1% dhe brezi bregujor me gjerësi 5 m.

Nga harta e sipërme – Harta e sipërfaqes vërshuese Q1% bashkë me brezin bregujor në gjerësi prej 5 m¹, konstatohet pjesërisht, pranë objekteve që përfshihen në zonë vërshuese, konstatohet edhe forma gjeometrikisht e parregullt e perimetrit të brezit bregujor dhe atij të zonës vërshuese Q1%.

Gjithashtu, në aspektin rregullativ, pavarësisht formalizimit eventdual të objekteve jo-ujore në zonën vërshuese, zbatimi i kriterëve specifikë të legjislacionit përkatës nuk do të mund të realizohet pa ndërmarrjen e masave rregullative tekniko-ligjore.

Në figurën vijues paraqitet harta – ‘Sipërfaqja vërshuese Q1%’ bashkë me brezin bregujor në gjerësi 5 metra, në raport të akseve tematike të gjendjes kadastrale dhe aktuale.




Figura 4-13: Brezi bregujor i llogaritur ne kontekst te parcelave

Nga harta e mësipërme - Harta e sipërfaqja vërshuese Q1% bashke me brezin bregujor 5 m' mbi sfondin gjendjes kadastrale aktuale - konstatohet statusi 'pasurisë ujore publike kadastrale' i parcelave kadastrale: 10002-0 dhe 01003-3 (parcelat e hijezuara me ngjyrë te kaltër).

Ne vijim paraqitet harta e 'pasurisë ujore publike kadastrale'(hijezuar me ngjyre te kaltër) dhe i identifikim një pjesës përkatëse te sajë qe i përket shtratit te braktisur te ujerrjedhes(hijezuar me ngjyre te verdhe), se cilës i ka pushuar funksioni i destinimeve te përcaktuara me Nenin 9 te UA Për Rregullimin e Statusit te Pasurisë Ujore dhe e njëjta duhet

proceduar me tej për ndërprerje te statusit te ‘pasurisë ujore publike’ ne përputhje me Nenin 12 te UA ne fjale. Gjithashtu, paraqiten aksi i shtratit aktual (të ri) te lumit, zona vërshuese Q1% hijezuar me ngjyrë te kaltër vizibile, brezin bregudor me gjerësi prej 5m’ me hijezim ngjyrë te verdhë dhe kufijtë e parcelave tematike me vija te ndërprera ‘vizë-vizë ngjyrë të verdhë’.




Figura 4-14: Akset e Ujrrjedhes faktike dhe kadastrale ne begrand parcelave

Gjithashtu, në hartën paraprake konstatohet ‘devijimi’ i aksit te shtratit lumit nga aksi kadastral i shtratit te vjetër te ujërrjedhës, si pasojë e ‘prerjes’ se meandrës me rreze të parregullta meandruese te kriterit praktikave $R > (5-8)B$ (ku B-gjerësia e shtratit ujërrjedhës).

Për faktin se forma gjeomerikisht e parregullt e perimetrit të brezave bregudorë, si dhe duke pasur parasysh se kufiri i pasurisë ujore duhet jetë poligon i rregullt e praktik në Sistemin Koordinativ *KosovaRef* (në shkallë së paku 1:5000), rezultojnë nevojat për rirregullim praktik e profesional të kufirit të pasurisë ujore.

Në rastin konkret në harmoni me situatën kadastrale të 'pasurisë ujore publike' (parcelat: 10002-0 dhe 01003-3), parregullsinë e pjesshme gjeometrike të 'brazave bregudorë', rezultojnë nevojat e përcaktimit të poligonit mbështjellës ('anvelope') të brezave bregudorë, i cili në integrim me këto të fundit, rezultojnë sipërfaqet shtesë të pasurisë ujore në dy anët e ujërrjedhës si në figurën vijuese.




Figura 4-15: Brezi bregujor llogaritar ne begrand te parcelave kadastrale.

Nga harta e mësipërme qartësohet, se kufiri aktual kadastral i pasurisë ujore – kufiri i pasurive aktuale te ‘pasurive ujore publike’ zgjerohet majtas e djathtas ujërrjedhës me sipërfaqe prej 10815 m²(majtas) dhe 5719 m² (djathtas) sipas vijave poligonale me koordinatat e pikave poligonale te paraqitura ne tabelën e radhës.

Sipërfaqja e ‘pasurisë ujore publike kadastrale’ ne segmentin tematik me vetëm 1760 m² është vetëm 9.6 % e sipërfaqes se ‘pasurisë ujore private’ me sipërfaqe totale prej 18294 m². Përderisa ndërhyrja e ‘pasurisë ujore private’ ne sipërfaqen e parcelës tematike 00575-0 te “Gllareva” SH.P.K është 56 % te sipërfaqes se parcelës ne fjale.

Raporti i këtillë i disfavorshem i ‘sipërfaqes ujore private’ ndaj ‘sipërfaqes ujore publike’, kriteret kufizuese te ndërtimit te objekteve ekonomike ne ‘pasuritë ujore private’ (Neni 9 UA për Statusin e Pasurisë Ujore), parimi i shfrytëzimit normal të palujtshmerise–ekonomizimit parcelës, justifikojnë një zgjidhje tekniko-ekonomike te rregullimit te shtratit te lumit ne segmentin tematik te karakterit publiko-privat.

Ne vijim paraqiten koordinatat e pikave poligonale te ‘sipërfaqeve poligonale te shtuara’ te ‘pasurisë ujore’ ne Sistemin Koordinativ KosovaRef.

Table 4-1:Kordinata e pikave poligonale

Table					
Pik.Polig.Pas.Ujore					
	FID	Shape *	Id	Xcord	Ycord
	0	Point	0	7505520	4719050
	1	Point	0	7505500	4719060
	2	Point	0	7505480	4719090
	3	Point	0	7505470	4719120
	4	Point	0	7505480	4719120
	5	Point	0	7505470	4719160
	6	Point	0	7505460	4719220
	7	Point	0	7505480	4719270
	8	Point	0	7505490	4719290
	9	Point	0	7505530	4719290
	10	Point	0	7505540	4719290
	11	Point	0	7505550	4719270
	12	Point	0	7505550	4719220
	13	Point	0	7505560	4719190
	14	Point	0	7505560	4719140
	15	Point	0	7505560	4719110
	16	Point	0	7505540	4719080
	17	Point	0	7505530	4719060

Sipërfaqja e ndërhyrjes së shtratit aktual nga kufiri i pasurisë ujore publike në parcelën tematike 00575 të "Gllareva" SH.P.K është rreth 11.5 ari (1150 m²), kurse ndërhyrja e sipërfaqes së 'pasurisë ujore private' në të është rreth 10815 m².

Për qartësim të mëtejme të devijimit të aksit të shtratit aktual të lumit nga ai kadastrale përmes prerjes së 'meandrit' të mëparshëm kadastral me rreze përkatëse meandruese në figurën vijues paraqitet me detajisht dispozita e akseve tematike, sipërfaqja e pasurisë ujore publike me status të ndryshuar.




Figura 4-16: Pasuria ujore publike me status ndryshuar

Për faktin se riparcelizimi, regjistrimi i pasurive ujore në Kadastër dhe Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme (Ligji i Regjistrimit të Paluajtshmerive/2008) kadastrë dhe regjistër të paluajtshmerive, formalisht kërkon involvimin e gjeometrit të licencuar sipas legjislacionit të Kosovës, statusi i pronave jo-publike (private) për rreth 'pasurive ujore publike' dhe 'pasurive

ujore publike për ndërprerje të statusit’ integrohet nga ana e gjeometrit gjate proceseve të theksuara paraprakisht.

Me qëllim të përcaktimit të të dhënave të shënimit gjeometrik të sipërfaqes së pasurisë ujore kadastrale, se cilës duhet t’i ndërpritet statusi i ‘pasurisë ujore publike’ në harmoni me Nenin 12 të UA Për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore, ne vijim paraqite dispozita teknike kontekstuale e parcelës në fjalë me sipërfaqe prej 649 m², dhe kufiri i pasurisë në fjalë përmes pikave poligonale me koordinatat përkatëse në sistemin koordinativ *KosovaRef*.




Figura 4-17: Parcela për ndryshim të statusit

Nga figura e mësipërme identifikohen pikat poligonale të kufizimit të pjese sipërfaqes së ‘pasurisë ujore publike kadastrale’ se cilës i ka pushuar funksionaliteti destinues sipas Nenit 9 të UA Për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore, dhe duhet proceduar me të për ndryshim formal të statusit në harmoni me dispozitat përkatëse të UA në fjale. Sipërfaqja në fjale e madhësisë prej 649 m² kufizohet majtas me konturat e shtratit të ri të lumit (vija me ngjyrë të kaltër). Duhet theksuar se sipërfaqja në fjale është pikërisht kërkesë lëndore e “Gllareva” SH.P.K për rivendosje të shtratit të lumit në gjendje kadastrale, respektivisht kthim të shtratit të lumit në ‘pasuri ujore publike kadastrale’

Gjithashtu, nga figura paraprake identifikohet dhe veçanërisht shfrytëzimi joformal i pjesës se ‘parcelës ujore kadastrale’ nga veprimtari transport-biznesi (mbuluar me plato betoni) dhe ndërtim joformal (sipas legjislacionit të ujërave) në anën perëndimorë të sipërfaqes në fjalë.

Në vijim paraqiten koordinatat e pikave poligonale të ‘sipërfaqeve poligonale të përcaktuara për ndërprerje të statusit të pasurisë ujore publike’ në Sistemin Koordinativ *KosovaRef*.

Table 4-2: Kordinata e pikave poligonale për ndërprerje të statusit pasurisë ujore

Table					
Pik_Polig					
	FID	Shape *	Id	Xcord	Ycord
▶	0	Point	0	7505530	4719290
	1	Point	0	7505530	4719290
	2	Point	0	7505550	4719300
	3	Point	0	7505550	4719310
	4	Point	0	7505540	4719320
	5	Point	0	7505530	4719320
	6	Point	0	7505520	4719320
	7	Point	0	7505520	4719320
	8	Point	0	7505510	4719330
	9	Point	0	7505520	4719330
	10	Point	0	7505540	4719320
	11	Point	0	7505560	4719320
	12	Point	0	7505560	4719310
	13	Point	0	7505560	4719300
	14	Point	0	7505540	4719280

1 (0 out of 15 Selected)

Pik_Polig

4.4 Konkluzionet Lëndore

Bazuar në kriteret e përcaktuara ligjore si dhe në gjetjet e prezantuara në seksionet paraprake të këtij raporti, mund të nxjerrën konkluzionet vijuese:

- 1) Pjesëmarrje sipërfaqes se 'pasurisë ujore publike kadastrale' me vetëm 9.6 % ne sipërfaqen totale te 'pasurisë ujore' ne segmentin tematik te lokacionit "Gllareva" SH.P.K, është ne disfavor te shfrytëzimit normal ekonomik te parcelave private qe përfshihen ne zonën me status 'pasuri ujore' si 'pasuri ujore private', si pasojë e kufizimeve te destinimeve nga Neni 9 i UA për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore.
- 2) Distanca me shkurtër e gabaritit te objektit "Gllareva" sh.p.k. nga konturat e shtratit bazik te lumit(shtratit te lëvizjes se ujit kur nuk ka përmbytje) është 43 m' , përderisa distanca përkatëse e objektit te parë djathtas ujërrjedhës është 8m' kurse e objektit te dytë (poshtëm) është (0-1m'), distanca këto ne mospërputhje te plotë me distancën minimale prej 10 m' sipas Nenin 12/1.3 UA MMPH Nr.04/2016 për Kriteret dhe Procedurat për Mbrojtjen e Brigjeve te Ujërrjedhave.
- 3) Nga sipërfaqja totale 20191 m² e parcelës tematike 00575-0 ne pronësi "Gllareva" sh.p.k., 10815 m² ose 53.5 % e sipërfaqes se saj duhet formalizuar 'pasuri ujore private', si rezultat i kësaj ka për pasojë jo-ekonomitet i parcelës tematike private, si rezultat i kufizimit te veprimtarive shfrytëzuese.
- 4) Një pjesë e sipërfaqes se 'pasurisë ujore publike', pjesa me sipërfaqe prej 649 m² e përshkruar me kufijtë e pikave poligonale si ne figurën paraprake, procedohet tutje për ndryshim te statusit te 'pasurisë ujore publike' ne harmoni me Nenin 12 te UA për Rregullimin e Statusit te Pasurisë Ujore.
- 5) Pa ndërmarrjen e masave tekniko-ekonomike projektuese e ndërtuese te rregullimit te segmentit tematik lumore, pamundësohet zbatimi i dispozitave relevante te legjislacionit përkatës te ujerave, pavarësisht zbatimit eventual te legjislacionit tjetër te ndërtimit te objekteve ne lokacionin tematik.
- 6) Kërkesa "GLLAREVA" SH.P.K për rikthim te një segmenti te shtratit aktual te lumit ne shtratin e vjetër te lumit (gjendje para hartimit te hartës topografike te Kosovës 1:25000 ose rreth 40-viteve), për shkak gjerësisë tepër te vogël te parcelës se 'pasurisë ujore publike', e te pamjaftueshme për nevoja projektuese te 'shtratit te ujerave te mëdha me Q1%, konsiderohet variant i zgjidhjes optimale projektuese gjate hartimit te 'Projektit te Rregullimit te Lumit Graçanka ne segmentin e lokacionit "Gllareva" SH.P.K
- 7) Ne harmoni me Nenin 13 te UA MMPH Nr.05/2016 për Rregullimin e Statusit te Pasurisë Ujore, përgjegjësia e menaxhimit te pasurisë publike ujore përfshirë edhe

parcelën tematike 00575-0, Zona Kadastrale Vragoli, Komuna e Fushe Kosovës, është përgjegjësi e ARPL.

4.4 Rekomandimet Lëndore

Duke pasur parasysh faktin se:

- (a) zona vërshuese e segmentit lumore ne lokacionin "Gllareva" SH.P.K predominohet nga sipërfaqja e 'pasurisë ujore private' (16534 m²) ne raport rreth 9:1 me sipërfaqen e 'pasurisë ujore publike kadastrale' (1670 m²), e si e këtillë ka ndikim esencial ne ekonomitetin e parcelave private përkatës,
- (b) mungesa e masave tekno-ekonomike te rregullimit/normalizimit balancues (publiko-privat) te 'rregullimit te shtratit te ujerave te mëdha' ne lokacionin lëndor, pamundëson implementimin rregullativ te legjislacionit te ujerave,
- (c) të drejtat e realizimit te nderimit eventualisht munde te jene te bazuara në legjislacionet tjera përkatëse,
- (d) Zona në fjalë është e rrezikuar nga përmbytjet e shpeshta,

rekomandohet që:

- 1) MMPHI ne bashkëpunim me 'pronarët e parcelave përgjatë lumit Graçanka ne lokacionin 'Gllareva' sh.p.k. ne parim te partneritetit' publiko-privat' ose formë tjetër te marrëveshjes, të planifikojnë realizimin e një projekti kapital për 'Rregullimin me restaurim te lumit Graçanka ne segmentin pranë lokacionit te 'Gllareva' sh.p.k. ne Z.K. Vragoli, komuna e Fushë Kosovës.
- 2) Pas rregullimit të seksionit të lumit Graçanka siç rekomandohet në pikën 1) më sipër, të përcaktohen kufijtë e pasurisë ujore në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm (që aktualisht përfshin brezin prej 5 metrave prej kufirit të strukturave mbrojtëse/rregulluese të lumit për ujërat e mëdha);
- 3) Pas përcaktimit të kufirit të pasurisë publike ujore sipas rekomandimit në pikën 2) më sipër, mund të ndërmerren veprimet e duhura administrative dhe ligjore për rregullimin statusit të pronës tokësore jashtë kufirit të pasurisë ujore të përcaktuar (ndërprerja e statusit të pasurisë ujore, dhënia në shfrytëzim e kësaj prone për destinime tjera etj.).

5. KONKLuzionet e Përgjithshme

Me qëllim avancimit të procedurave të përgjithshme të trajtimit administrativo-teknik të 'pasurive ujore', paraqiten konkluzione udhëzuese si në vijim:

A. Konteksti i qasjes parimore

1. **Qasja ndaj trajtimit të lëndëve** konkrete administrative duhet filluar nga praktika parimore e gjykatave: citat "Gjykata niset nga premisa që një akt normativ duhet të interpretohet në kuptimin që lejon zbatimin e tij, jo në atë që e përjashton këtë zbatim"¹;
2. **"Fakti që një dispozitë ligjore mund të ketë më shumë se sa një mënyrë interpretimi**, nuk e bën atë të paqartë. Përkundrazi, ligji nuk duhet të jetë shterues dhe i ngurtë, por duhet t'u lërë hapësirë interpretimi organeve administrative dhe gjyqësore, në varësi të rrethanave konkrete dhe zhvillimit të normave në kontekst të praktikës"²;

B. Konteksti i se drejtës së shfrytëzimit të pasurive publike ujore për nevoja ekonomike

1. **Në gjuhë të thjeshtë ekonomiko-inxhinierike**, për faktin se sipërfaqet e pasurive ujore rezervohen kryesisht për mbrojtje nga ngjarjet e vërshimeve mesatarisht në interval kohor 1 herë në 100 vjet, ngjarje e cila zgjat mesatarisht (2-3 ditë) në 100 vite, rezultojnë absurditet ekonomik mos-shfrytëzimi i tyre për 36497 ditë tjera në atë periudhë kohore.
2. **Legjislacionet dhe praktikat e vendeve të rajonit** e me gjerë, dëshmojnë për rregullimin me ligje të posaçme të dhënies së shfrytëzimit të tokës ujore edhe për persona juridikë sipas së drejtës së qirasë, servitutit e të drejtës ndërtimore' varësisht nga natyra e shfrytëzimit^{3,4}. Legjislacionet e theksuara çështjen e 'pasurive ujore' rregullojnë përmes vendimeve dhe kontratave.
3. **Përmbajtja rregulative e legjislacionit aktual** në Kosovë nuk posedon dispozita ligjore që rregullojnë ose kontestojnë shprehimisht shfrytëzimin e parcelave të 'pasurive ujore' për nevoja ekonomike, kuptohet në respektimin e kriterëve të statusit e destinimit të tyre-rregullimi dhe përmirësimi i regjimit të ujerave të përcaktuara me Neni 9 i *UA për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore*.
4. **Legjislacioni pozitiv primar e sekundar vendor** i fushës së ujerave nuk përjashton aplikimin subsidiar të *Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore*, në

¹ Manual për Hartimin e legjislacionit 2021/Republika e Shqipërisë

² Manual për Hartimin e legjislacionit 2021/Republika e Shqipërisë

³ Neni 18 i Ligjit për Ujëra të Kroacisë" (1) Personave juridikë dhe fizikë mund t'u jepen të drejta qiraje, qiraje, servituti dhe ndërtimi në një pjesë të pronës publike ujore për të përmbushur nevojat e tyre ekonomike ose personale, vetëm nëse kjo e drejtë nuk do të ndikojë në realizimin e qëllimeve të përmendura në Neni 10 i këtij ligji. (si psh. mirëmbajtja dhe përmirësimin e regjimit të ujerave ,mbrojtjen nga vërshimet etj)

⁴ Neni 10 Ligji për Ujërat e Serbisë

trajtimin e te drejtës se dhënies ne shfrytëzim te palujatshmërive (pasurive ujore publike) sipas se drejtës se qirasë, servitutit e ndërtimit(Nenet 253,265, 275 te ligjit tematik), ku përveçqë tjerash, lejohet edhe kompensimi ne ‘pagesa te përsëritshme’ nga shfrytëzimi i patundshmërisë.

5. Neni 253 i *Ligji Nr. 03/L-154 Për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore*, përveç me ligj, lejon dhënien e servitutit te paluejtshmerive edhe me vetëm ‘një vendim te organit shtetëror’, pra çështja e servitutit ne mënyre eksplicite mund te rregullohet vetëm me vendim përkatës, nëse me ligj te veçantë nuk parashihet ndryshe.
6. Drafti i *Ndryshim/Plotësimit te Ligjit për Ujera 2022* si dhe Drafti i Ligjit te Ri për Ujera 2022 ne harmoni me standardet e praktikat e vendeve të rajonit sa i përket rregullimit te statusit pasurive ujore dhe shfrytëzimit te pasurive ujore publike, përcaktuan edhe dispozita ligjore për “Shfrytëzimi i tokës ujore publike për veprimtari ekonomike apo personale” dhe përcaktimin ‘Lartësisë se pagesës për shfrytëzimin e pasurive ujore publike sipas Vendimit te Qeverisë. Plani Kombëtar për Zhvillim te Republikës se Kosovës 2023-2025 ka planifikuar Hartimin e Projektligjit te Ri për Ujera (K2/2024).
7. Me gjithë ekzistimin e bazës juridike aktuale (kryesisht me legjislacioni e ujërave e pjesërisht me Ligjin për Pronësinë) te dhënies se ‘pasurisë ujore publike’ sipas se drejtës se qirasë, servitutit e se drejtës ndërtimore, deri ne hartimin e bazës eksplicite ligjore me Ligjin e Ri për Ujëra përcaktuar ne paragrafin paraprak, ne harmoni me balancimin e parimeve proporcionale, procedimi formal dinamik i kërkesave përkatës te aplikohet ne funksion te legjislacionit pozitiv dhe fuqizimit te Ligjit te Ri për Ujera si ne vijim:

1.Me përjashtim te kërkesave për shfrytëzim te ‘pasurive ujore publike’ nga ana aktiviteteve biznesore , te gjitha kërkesat tjera adresuar ne ARPL trajtohen ne harmoni legjislacionin pozitiv te ujerave ne subordinim me Ligjin përkatës te Pronave dhe praktikave te rregullave profesionale;

2. Kërkesat për shfrytëzim te ‘pasurise ujore publike’ trajtohen ne funksion te fuqizimit te Ligjit te Ri për Ujera si ne vijim:

- 2.1 Realizohet shqyrtimi administrative;
- 2.2 Kërkohen dokumentacionet shtese ne harmoni me përmbajtjen praktike te Këtij Raporti;
- 2.3 Realizohet shqyrtimi teknik i pakos se dokumentacionit lidhur me çështjen.
- 2.4 Përgatitet ‘Raporti teknik i shqyrtimit lëndor’
- 2.5 Dinamika e Rekomandimeve te ARPL për Ministrin realizohet ne funksion te fuqizimit te Ligjit te Ri për Ujëra.

6. REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME

Deri ne hartimin e bazës ligjore me Ligjin e Ri për Ujëra, procedimi formal i kërkesave për shfrytëzimin e pasurisë ujore të bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi të ujërave (Ligjin për Ujëra dhe aktet nënligjore të nxjerra në pajtim me këtë ligj), duke pasur parasysh si vijon:

1. Kërkesat për dhënien në shfrytëzim të pasurisë ujore publike për aktivitete biznesore të mos aprovohen duke pasur parasysh se sipas *UA për Rregullimin e Statusit të Pasurisë Ujore*, në pasurinë publike ujore mund të ndërtohen vetëm objekte të cilat janë në interes publik (si rregullim dhe mirëmbajtja e ujërave, mbrojtja e natyrës, shfrytëzimi i ujërave, mbrojtja e ujërave nga ndotja, infrastruktura publike si rrugët dhe urat, nevojat e organeve shtetërore për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore etj.).
2. Pasuria ujore publike mund të shfrytëzohet për pushim dhe rekreacion në mënyrën siç e përcakton komuna në territorin e të cilës është ajo pasuri ujore, me pëlqimin paraprak të ARPL. Ky shfrytëzim nënkupton krijimin e zonave për larje por jo edhe ndërtimin e objekteve me karakter afarist që mund ta rrezikojnë destinimin që ka pasuria publike ujore për mbrojtjen dhe rregullimin e ujërave.
3. Pasuria ujore publike nuk mund të tjetërsohet e as të këmbëhet. Prandaj kërkesat për tjetërsimin e pasurisë ujore publike apo për këmbimin e saj me prona private nuk mund të aprovohen.
4. Nëse ka pasur devijim të shtratit të lumit nga parcela kadastrale e pasurisë ujore publike në prona private, këto kërkesa duhet të shqyrtohen nga ARPL duke pasur parasysh me këtë rast regjimin ujqor të lumit dhe aspektet pronësore. Bazuar në praktikën e vendeve të rajonit, rekomandohet që në këto raste të planifikohet kthimi i lumit në shtratin origjinal të regjistruar në libra kadastral, ndërkaq financimi i kostove për rregullimin e shtratit të lumit të bëhet nga buxheti i shtetit dhe pronari i pronës së dëmtuar nga devijimi i lumit.
5. E drejta e servitutit në pasurinë ujore publike mund të jepet për rastet e shfrytëzimit të ujit të lumit (për ndërtimin e veprave ujëmarrëse dhe tubacioneve përcjellëse) apo për tubacionet për shkarkimin e ujërave të ndotura. Kërkesat e këtilla duhet të trajtohen si në vijim:
 - Zbatohet shqyrtimi administrativ në pajtim me UA për Leje Ujore;
 - Kërkohet dokumentacion shtesë në harmoni me problematikat e përshkruara në këtë raport me legjislacionin përkatës;
 - Realizohet shqyrtimi teknik i dokumentacionit lidhur me çështjen që trajtohet;
 - Përgatitet ‘Raporti teknik i shqyrtimit lëndor’;
 - Dinamika e Rekomandimeve të ARPL për vendimmarrje nga ana e Ministrit ose SP/MMPHI sipas rasteve mund të bëhet në funksion të fuqizimit të bazës ligjore me Ligjin e Ri për Ujëra.
6. Një pasurie ujore publike mund t’i ndërpritet statusi i saj, vetëm me vendim të Ministrit apo të Qeverisë së Kosovës. Këto raste mund të përfshijnë shembuj si: futja e një përroskë apo kanali të hapur në tuba (rasti i lumit Prishtevka, përroi i Vëlleshës etj.).

7. SHTOJCAT

7.1 Lënda: PARKU I BIZNESIT NË MITROVICË

01-030/04 - 0103342 / 14
17.11.2022

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Datë/a:	11.11.2022
Për/Za/To:	z. Albín KURTI – Kryeministër i Republikës së Kosovës dhe Kryesues i Këshillit Ndërmnistror për Ujërat; z. Liburn ALIU – Ministër i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe anëtar i Këshillit Ndërmnistror për Ujërat.
Nga/Od/From:	z. Bedri HAMZA - Kryetar i Komunës së Mitrovicës;
Tema/Subjekat/Subject:	Parku i Biznesit në Mitrovicë;

I nderuar Kryeministër z. KURTI,

I nderuar Ministër z. ALIU,

Parku i Biznesit në Mitrovicë ka filluar punën dhe është themeluar në vitin 2002 me Vendim të Kuvendit Komunal, dhe në vitin 2006 me Vendim të Kuvendit Komunal në Mitrovicë është dhënë në shfrytëzim toka ndërtimore me qëllim të implementimit të projektit "Parku i Biznesit" në Mitrovicë.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike, Komuna e Mitrovicës ka aplikuar për krijimin e Zonës Ekonomike "Parku i Biznesit" në Mitrovicë. Parku është krijuar Zonë Ekonomike me Vendim të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me datë 08.10.2012, dhe me Vendim të Kryeministrit të Republikës së Kosovës me datë 17.10.2012.

Parku i Biznesit në Mitrovicë ka sipërfaqe prej 3.5ha, dhe në këtë Park janë të vendosura 22 Biznese, me rreth 300 të punësuar, i cili Park është themeluar me investim të Zyrës së Bashkimit Evropian, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Komunës së Mitrovicës, si dhe Bizneseve me vlerë 5,921,517.00 €, shumë kjo e cila është shumëfishuar me zgjerimin dhe investimet e bizneseve.

Page 1 of 2

Parcelat në të cilat shtrihet Parku i Biznesit janë të shtrira në 3 Prona, ku njëra ndër të cilat është edhe Prona me Nr. e Fletës Poseduese 3305 "Pronë Shoqërore" (të Mirat Publike të Ujërave) me sipërfaqe të përgjithshme 13.87,05 ha, ku nga sipërfaqja e përgjithshme e kësaj parcele, është dhënë në shfrytëzim për Parkun e Biznesit sipërfaqja prej 0.84,53 ha.

Kontratat në Parkun e Biznesit kanë qenë 10 vjet me mundësi vazhdimi, ku këto Kontrata janë dhënë në vitin 2004 deri në 2006, dhe të njëjtat kanë skaduar në vitin 2014 respektivisht, 2016. Nga viti 2014, respektivisht 2016 e tutje të gjitha bizneset në Parkun e Biznesit operojnë pa Kontrata, dhe rrjedhimisht është krijuar një boshllëk ligjor i cili ka hapur mundësitë që bizneset aty të mos paguajnë qiratë, dhe të mos e ushtrojnë si duhet veprimtarinë afariste.

Tani më, ne jemi duke e trajtuar me seriozitet të madh Parkun e Biznesit për të rregulluar statusin e tij, sepse bizneset e vendosura po insistojnë në largim të investimeve pasi që nuk kanë Kontrata dhe nuk po mund të zgjerojnë investimet e tyre.

Prandaj, kërkojmë nga ju në cilësinë e Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe në cilësinë e Kryesuesit të Këshillit Ndërmënor për Ujërat, që të ndërmerrni hapa konkret në "Dhënie e Pëlqimit", apo të përcaktoni që kjo Pasuri Ujore Publike të shfrytëzohet për interes të Parkut të Biznesit, sepse pa zgjedhjen e statusit të kësaj parcele, ne e kemi të pamundur të procedojmë me parcializimin e Parkut dhe funksionalizimin e tij.

Ju lus, ta trajtoni si çështje me prioritet, sepse nga ky Park janë të varura 22 Biznese të mëdha të vendit, dhe rreth 300 punëtor të cilët punojnë në këto biznese, e në rast të mos zgjidhjes së statusit të këtij Parku, të njëjtat do të largohen, me ç'rast shumë punëtor do të mbesin pa vendet e tyre të punës.

Me respekt,

Dokumentet e bashkangjitura:

Dosja complete e Parkut të Biznesit në Mitrovicë





MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTRIJA E OKRUŽJA, PROJEKTOVANJA I PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRIE OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AQD2
02

PRISHTINË / A

15.03.22
17.03.22



15-030/64-0025356/22
16.03.2022

Mitrovica - Mitrovica



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica



DATE/A:	15.03.2022
REFERENCE:	
PËR/ZA/TO:	Ministria e Mjedisit, Planifikimit dhe Infrastrukturës Autoriteti Rajonal të Pëllgjeve Lumore (ARPL)
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Bedri Hamza, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	Drejtori i D.G.J.K.P. Artan Berisha
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	PËLQIM



Të nderur,

Përmes kësaj shkrese, Komuna e Mitrovicës Jugore, kërkon nga Ministria e Planifikimit Hapsinor respektivisht nga Drejtoria e Ujrave, që të na ipet Pëlqimi për shfrytëzimin e hapësirave përreth Lumit Sitnica, me qëllim të menaxhimit sa më mirë të kësaj hapësire nga ana e Komunës, dhe në interes të përgjithshëm publik.

Menaxhimi i këtij aseti nënkupton: shfrytëzimi, mirëmbajtja dhe ruajtja e kësaj pasurie, në mënyrë që ajo të jetë në gjendje që të shërbejë destinimit të përcaktuar.

Edhe me Planin Zhvillimor Komunal 2020-2028 të miratuar nga Kuvendi Komunal në Mitrovicë, e i aprovuar edhe nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit, shfrytëzimi aktual është në harmoni të plotë me Destinimin e shfrytëzimit të tokës sipas PZhK, ku llogaritur që përshkruhet nga lumi Sitnica potencohet si potencial për zhvillimin Zonës së Biznisit e cila edhe tani është funksionale, e cekur si Prioritet i Zhvillimit Strategjik.

Me Respekt!



Duke u bazuar në nenin 3 të Ligjit për Tokën Ndërtimore (Fleta Zyrtare e Kosovës Nr. 14/80), nenin 12 pika 2, 5 dhe 8 të Statutit të Kuvendit të Komunës, nenin 3 pika a, b, c dhe h të Rregullores Nr. 2000/45 Mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, nenin 4, 5 dhe 23, pika 3 të Rregullores Komunale Nr. 6/2002 Për dhënie në shfrytëzim të tokës ndërtimore, neni 7 pika 5 e Rregullores Komunale Nr. 08/2002, mbi kriteret dhe lartësinë e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore; Kuvendi i Komunës në mbledhjen mbajtur më dt. 24.02.2006 sjell:

VENDIM

Për dhënie në shfrytëzim të tokës ndërtimore me qëllim të implementimit të projektit "Parku i Bizneseve"

1. Me qëllim të implementimit të Projektit "Parku i Bizneseve", projekti i miratuar me vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 215/01 dt. 21.05.2002 me të cilin është paraparë ndërtimi i objekteve prodhuese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, Kuvendi i Komunës jep në shfrytëzim tokën ndërtimore:

a) Nga Fleta poseduese Nr. 3300 pronë shoqërore e Kuvendit të Komunës ipen në shfrytëzim:

- Nga ngastra kadastrale 2459 në vendin e quajtur "Lumi Sitnica" nga sipërfaqja e tërësishme prej 0.42,31 ha, në shfrytëzim ipet sipërfaqja prej 0.05,81 ha.
- Nga ngastra kadastrale 2670/1 e cila gjendet në vendin e quajtur "Fusha Samish" nga sipërfaqja e tërësishme prej 1.11,61 ha, në shfrytëzim ipet sipërfaqja prej 0.82,14 ha.
- Nga ngastra kadastrale 2672 në vendin e quajtur "Fusha Senish"/Furra ushtarake, nga sipërfaqja e tërësishme prej 0.27,97 ha, në shfrytëzim ipet sipërfaqja prej 0.04,02 ha.
- Nga ngastra kadastrale 2681/1 në vendin e quajtur "Fusha Samish" nga sipërfaqja e tërësishme prej 1.15,88 ha, ipet në shfrytëzim sipërfaqja prej 0.56,40 ha.
- Nga ngastra kadastrale 2681/2 në vendin e quajtur "Fusha Samish" nga sipërfaqja e tërësishme prej 1.03,05 ha, në shfrytëzim ipet sipërfaqja prej 0.43,72 ha.

b) Nga Fleta poseduese Nr. 3305 pronë shoqërore (të mirat publike të ujërave)

- Nga ngastra kadastrale Nr. 3548/1, në vendin e quajtur "Lumi Sitnica" nga sipërfaqja e tërësishme prej 13.87,05 ha, në shfrytëzim ipet sipërfaqja prej 0.84,53 ha.

c) Nga Fleta poseduese Nr. 3307 pronë shoqërore KXMK "Trepça" Mitrovicë

- Nga ngastra kadastrale 3611 në vendin e quajtur "Fusha Senish", nga sipërfaqja e tërësishme prej 0.23,67 ha, në shfrytëzim ipet sipërfaqja prej 0.06,58 ha.

2. Sipërfaqja e cekur në pikën 1 të këtij vendimi ipet në shfrytëzim në afat prej 10 vitesh.

3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Dorëzohet:

- 1 x 1 Kryetarit të Kuvendit
- 1 x 1 Kryeshefit të Ekzekutivit
- 1 x 1 Drejtorisë për ekonomi dhe zhvillim
- 1 x 1 Drejtorisë së inspeksionit
- 1 x 1 Drejtorisë për gjeodezi, kadastr dhe planifikim urbanizim (të shërbimeve) dhe banim
- 1 x 1 Arkivit

Mitrovicë
24.02.2006



Kryetari i Kuvendit
Mr. sc. Mursel IBRAHIMI

*Qingja / Komuna e Mitrovicës /
Në 13 UA për Shk. Punuv. Gjere
Komuna eshte pergj. për zbatim un bore.*

7.2 Lënda: “GLAREVA”SH.P.K

 REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / РЕПУБЛИКА КООСОВА MINISTRIA E EMBETIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURË MINISTARSTVO OBUZGOVET, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF EQUIPMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jednica Org.Unit	Nr i Prot. Broj Prot. Prot. No
Nr i Faqeve Br. Stranica No. Pages	Data Datum Date
PRISHTINË / A No. 1	

Për: Autoritetin Rajonal të Pellgjeve Lumore
- Pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nga: “Gllareva ” sh.p.k., me Numër Unik Identifikues 811281865, me adresë në Gllareve pn, Klinë, të cilën e përfaqëson Genc Morina si përfaqësues ligjor, me të njëjtën adresë (nr. tel. 049/888-777).

Lënda: Kërkesë për lejimin e kthimit të rrjedhes së lumit Graçanka në shtratin original të lumit, sipas Kopjes së Planit të Ngastrës Kadastrale P-72514011-00575-0, Zona Kadastrale Vragoli, Komuna e Fushë Kosovës.

Prishtinë, 14.02.2022

Të nderuar,

“Gllareva ” sh.p.k. me Numër Unik Identifikues 811281865, me adresë në Gllareve, pn, Klinë, biznesi i cili ka njësinë në fshatin Vragoli, komuna e Fushë Kosovës, më saktësisht në ngastrën Kadastrale P-72514011-00575-0 (ndërtesa O-72514011-00575-0-1-0).

Provë: Certifikata e regjistrimit të biznesit në ARBK;

Provë: Letërnjoftimi i paraqitësit të kërkesës; dhe

Provë: Kopja e planit të ngastrës kadastrale lëndore, Zyra Kadastrale Komunale në Fushë Kosovë.

Sipas Kopjes së planit të bashkangjitur me këtë kërkesë, lumi Graçanka rrjedh pranë ngastrës kadastrale P-72514011-00575-0, Zona Kadastrale Vragoli, Komuna e Fushë Kosovës.

Gjendja faktike megjithatë ndryshon nga gjendja e përshkruar në dokumenta kadastrale, ngase në realitet, lumi Graçanka rrjedh për nes ngastrës kadastrale ku është i vendosur objekti i biznesit tim, shumë pranë objektit të biznesit. Kjo ka ndodhur për shkak se lumi Graçanka e ka ndërruar rrjedhën e vet, duke formuar një shtrat të ri, i cili tani e përshkon Ngastrën Kadastrale P-72514011-00575-0, Zona Kadastrale Vragoli, Komuna e Fushë Kosovës.

Provë: Të bëhet vendshiqimi me ekspertin e gjeodezisë.

Meqenëse rrjedha e re e lumit Graçanka përmes ngastrës kadastrale të shfrytëzuar nga ana e biznesit e zvogëlon dukshëm sipërfaqen e ngastrës, si dhe e pamundëson shfrytëzimin optimal të kësaj ngastre kadastrale, është më se e nevojshme që të intervenohet në mënyrë që lumi Graçanka të kthehet në shtratin e tij ku edhe sipas dokumentave kadastrale është e shënuar rrjedha e tij. Në

këtë mënyrë, do të sigurohej shfrytëzimi i papenguar dhe i plotë i ngastrës kadastrale P-72514011-00575-0 nga ana e pronarit / shfrytëzuesit të saj, me çka do të na mundësohej realizimi i plotë i të drejtave pronësore në ngastrën kadastrale P-72514011-00575-0, Vragoli, Fushë Kosovë.

Duke u bazuar në faktet e cekura më lartë, e lus titullin e lartpërmendur që, pas shqyrtimit të provave dhe vlerësimit të gjendjes faktike, ta aprovojë këtë kërkesë, ashtu që të ma japë pëlqimin për kthimin e rrjedhës së lumit Graçanka në shtratin e tij origjinal – përkaj ngastrës kadastrale P-72514011-00575-0, Zona Kadastrale Vragoli, Komuna e Fushë Kosovës, sipas Kopjes së Planit, ashtu që të më lejohet që t'i kryej punimet sipas udhëzimeve të Autoritetit Rajonal të Pëllgjeve Lumore për kthimin e rrjedhës së lumit Graçanka.

Me respekt,

Genç Morina, nr. pers. 1000381581
„Gllareva” sh.p.k.
Gllareve, Klinë
nr. tel. 049/888-777



